

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5795
E premte, 7 qershor 2019
çmimi 0.40 €

LV-ja: Kosova pa sigurime
shëndetësore dhe pa
mbrojtje sociale për të
rrezikuarit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**KUSH ËSHTË BABA
I KOMBIT DHE PËR CILIN
KOMB E KENI FJALËN!? F. 11**

Sylejman
KRASNIQI



AKTUALE



**VESELI: SERBIA DO TA
NJOHË KOSOVËN DHE DO
TË PËRGJIGJET PARA
DREJTËSISË PËR
GJENOCIDIN F. 8**

**PROF. DR. EQREM ZENELAJ
NDERON ARKIVIN E
KOSOVËS DHE DREJTORIN E
SAJ RAMË MANAJ F. 8**



EKONOMI

**RUKIQI JEP VËREJTJE PËR
PROLONGIMIN E LEGJISLACIONIT
EKONOMIK F. 8**

**PUNËTORËT RREZIKOHEN NË
PUNË, KËRROHET MBYLLJA E
DISA VENDPUNISHTEVE F. 9**

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, RAMUSH HARADINAJ, ËSHTË PRITUR TË ENJTEN NË
BERLIN NGA KANCELARJA E GJERMANISË, ANGELA MERKEL | FAQE 4-5

Haradinaj mori mbështetjen e Merkelit për mbrojtjen e sovranitetit dhe për vizat



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë mbështetje të fuqishme për raportet bilaterale dhe rrugën evropiane të Kosovës nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel. Pas takimit që ka pasur të enjten në Berlin me Merkelin, Haradinaj ka thënë se me kancelaren gjermane ka biseduar edhe për dialogun me Serbinë, duke shprehur skepticizëm se marrëveshja përfundimtare mes dy vendeve mund të arrihet shpejt. Ai ka vlerësuar se pas këtij takimi Kosova është në një pozicion më të fuqishëm pasi ka marrë përkrahjen e Merkelit për mbrojtjen e sovranitetit dhe për vizat. Kurse kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e saj euroatlantike dhe për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar

Thaçi thotë se dialogu duhet të vazhdojë pa kushtëzime

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë i pakushtëzuar me synimin që të përmbillet me arritjen e një marrëveshje përfundimtare ndërmjet dy shteteve sovraane. Kështu ka deklaruar të enjten presidenti



Hashim Thaçi në një konferencë me gazetarë para nisjes për Sllovakë, ku do të marrë pjesë në Forumin e Bratisllavës. Ai ka thënë se sa më shpejt që të arrihet marrëveshja aq më shpejt do të lëvizet në të ardhmen evropiane | FAQE 3

**Pjesa e
parë e
testit të
maturës
fillon më
12 qershor**

| FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Holanda kundër hapjes së negociatave të Shqipërisë me BE-në

AMSTERDAM, 6 QERSHOR - Holanda e ka bërë fakt të kryer tashmë se nuk do të votojë që Shqipërisë t'i hapen negociatat. Lajmi është bërë i ditur nga ministri i Jashtëm i Holandës, Stef Blok. "Qeveria nuk është e interesuar në negociatat e pranimit midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë. Për Maqedoninë Veriore ajo e lë derën hapur. Këtë gjë e bëri të

qartë ministri i Punëve të Jashtme, Stef Blok. "Shqipëria ka akoma një rrugë të gjatë për të bërë", tha Blok. Por ai u shpreh më pozitiv për Maqedoninë e Veriut. Sipas tij, atje janë ndër-marrë hapa të mirë.

Deputetët kërkuan të mësonin qartësisht qëndrimin e Holandës për nisjen e negociatave dhe ministri ishte i prerë. "Por ata nuk

janë ende atje", ka ende diçka për t'u bërë në fushën e sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit.

Komisioni Evropian thotë se BE-ja duhet të fillojë bisedimet e pranimit me këto vende. Sipas komisionarit të Zgjerimit, Johannes Hahn, reformat që janë zbatuar këtu duhet të shpërblehen.

Deputetët donin të dëgjinin një

'Po' apo 'Jo' nga ministri në lidhje me vendimin për zgjerimin me këto dy vende. "Angazhimi nuk është i qartë", tha Pieter Omtzigt (CDA).

Blok mendonte se ishte mjaft i qartë. Sipas tij, asnjë vendim nuk mund të merret në BE nëse të gjitha shtetet anëtare marrin një pozicion të paracaktuar paraprakisht.



Kabinet houdt deur EU voor Albanië dicht

Wisner: Korrigjimi i kufirit Kosovë - Serbi, ide jorealiste

Ish-diplomati amerikan Frank Wisner ka thënë se ideja e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të ndodhë meqë mendon se kjo nuk është realiste dhe nuk ka mbështetje të mjaftueshme politike dhe të publikut brenda Kosovës për këtë çështje



PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ish-diplomati amerikan Frank Wisner ka thënë se ideja e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është realiste. Ish i dërguari i posaçëm amerikan për Kosovën theksoi se nuk ka mbështetje të mjaftueshme të publikut dhe politike në Kosovë dhe Serbi për një zgjidhje dhe korrigjim të kufirit. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës" ai ka thënë se ka nevojë për një qasje të re, pra është më e logjishme tani që ne vend të negociatave politike të nivelit të lartë për statusin, palët të përqendrohen në çështjet themelore të progresit dhe zhvillimit ekonomik.

Në lidhje me nismën e re nga Gjermania dhe Franca për rifillimin e dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit, Wisner ka uruar që kjo të shkojë mirë. "Këshilla ime e vetme për organizatorët është që kjo nismë të drejtohet në një mënyrë sa më modeste. Përndryshe, politikanët në rajon do të kapen me një çështje dhe do të krijojnë shumë vështirësi. Kjo ka ndodhur brenda në

Kosovë dhe në Bosnje, ku realitetet e brendshme politike tejkaluan synimet e mira të negociatorëve të jashtëm. Për këtë arsye në qasjen tonë ne kemi rekomanduar që të ketë një theks më të madh në integrimin ekonomik të rajonit në Evropë dhe menaxhimin me një nivel më modest të vështirësive afatgjata politike", ka thënë Frank Wisner.

Ish-diplomati amerikan ka thënë se është dakord me të gjithë ata që mendojnë se vendosja e tarifave ishte e paarsyeshme dhe ato duhet të hiqen. "Vendosja e tarifave ishte një gjest politik kundër Serbisë. Kjo nuk do të ndryshojë. Ka shumë avantazhe politike që mund të ndiqen nga të dyja palët. Për këtë arsye është më e logjishme tani që ne vend të negociatave politike të nivelit të lartë për statusin, palët të përqendrohen në çështjet themelore të progresit dhe zhvillimit ekonomik", ka thënë Wisner.

Sa i përket idesë për korrigjim të kufirit ose shkëmbim territore

mes Kosovës dhe Serbisë, Wisner ka thënë se askush nga jashtë nuk duhet të ketë mëdyshje ndaj serbëve ose kosovarëve në përpjekjet e tyre për të zgjidhur çështjet që i ndajnë ata. "Do të ishte në rregull,

nëse ata duan ta bëjnë këtë me korrigjim të kufirit. Por unë nuk mendoj se kjo do të ndodhë. Nuk mendoj se kjo është realiste. Nuk ka mbështetje të mjaftueshme të publikut brenda Kosovës, nuk ka mbështetje të

mjaftueshme politike për këtë. Dhe brenda Serbisë pa një masë të konsiderueshme progresi, nuk do ta mbështesnin një zgjidhje territoriale. Pra, unë nuk shoh një rrugë përpara në këtë drejtim", ka thënë Frank Wisner.

Gjermania ratifikoi Protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë Veriore në NATO

SHKUP, 6 QERSHOR - Protokollin për anëtarësimin të Maqedonisë së Veriut në NATO u votua edhe në Bundestagun gjerman duke u bërë kështu anëtar i 16 i NATO-s që mbylli këtë proces. Para se të kalohet në lexim të dytë, deputetët opozitarë tjetërsuan procedurat duke hyrë në debat për shkak të shtyrjes së debatit për negociatat me BE-në. Debatu u ashpërsua pasi që deputeti i Partisë së Gjellbër, Jurgen Tiritin, vlerësoi se

për bisedimet ndërmjet Shkupit dhe Brukselit ka konflikte të brendshme edhe në vetë qeverinë gjermane. "Kancelarja është kundër, kurse Ministria e Jashtëm angazhohet që bisedimet të fillojnë. Koalicioni nuk mund të arrijë pëlqim për këtë çështje. Dëshira e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut nuk ishte që të anëtarësohen vetëm në NATO, por të integrohen edhe në BE. Dyshimet e mia janë që

kancelarja Merkel do të shtyjë debatin për këtë çështje derisa Demokracia e Re të marrë pushtetin në Greqi për të bllokuar anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE", deklaroi Jurgen Tiritin, deputet i Partisë së Gjellbër.

Tiritin nga foltorja e Parlamentit tha se kryeministri grek Aleksis Cipras ka sakrifikuar karrierën e tij politike për t'u arritur Marrëveshja e Prespës, dhe për shkak të kësaj ai



tha se do ta humbë pushtetin në zgjedhjet e ardhshme. Pas Gjermanisë, protokollin për

anëtarësimin e vendit në NATO një ditë më parë e ratifikoi edhe Norvegjia.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për medie para nisjes për në Sllovaki, ku do të marrë pjesë në Forumin e Bratisllavës

Thaçi thotë se dialogu duhet të vazhdojë pa kushtëzime

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë i pakushtëzuar me synimin që të përmbillet me arritjen e një marrëveshje përfundimtare ndërmjet dy shteteve sovraane. Kështu ka deklaruar të enjten presidenti Hashim Thaçi në një konferencë me gazetarë para nisjes për Sllovaki, ku do të marrë pjesë në Forumin e Bratisllavës. Ai ka thënë se sa më shpejt që të arrihet marrëveshja aq më shpejt do të lëvizet në të ardhmen evropiane



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten ka udhëtuar për në Sllovaki, ku do të marrë pjesë në Forumin e Bratisllavës. Para nisjes ai ka mbajtur një konferencë me gazetarë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ku ka bërë me dije se në këtë forum do të diskutohet për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe për arritjen e marrëveshjes përfundimtare. "Në këtë forum do t'i prezantoj të arriturat e shtetit tonë në prag të 20-vjetorit të lirisë, në 11-vjetorin e pavarësisë si dhe hapjes së kapitullit konkret dhe të rëndësishëm për integritet në NATO dhe BE. Do të jetë një mundësi që të diskutohet edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe për mundësinë e arritjes së një marrëveshje përfundimtare dhe historike. Do të jetë një debat jo i lehtë me presi-

dentin serb Vuçiç, meqë ju i dini dallimet tona të mëdha që i kemi sa iu përket raporteve Kosovë - Serbi", është shprehur Thaçi. Presidenti ka deklaruar se procesi i dialogut ndërmjet dy vendeve duhet të vazhdojë i pakushtëzuar. "Do të ritheksoj qartë se dialogu Kosovë - Serbi duhet të vazhdojë i pakushtëzuar me synimin që të përmbillet me arritjen e një marrëveshje përfundimtare ndërmjet dy shteteve sovraane. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërish obliguese në rrafshin ndërkombëtar do t'i përmbilte të gjitha çështjet e hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë, që do të përfundonte me njohjen reciproke në mes të vendeve tona, që nënkupton njohjen nga pesë vendet e BE-së, gjithashtu perspektivë të sigurt për NATO dhe BE, por edhe anëtarësimin e Kosovës në OKB", ka theksuar Thaçi. Sipas presidentit, marrëveshja eventuale Kosovë - Serbi do të nënkup-

tonte më tepër paqe dhe stabilitet për Ballkanin Perëndimor, më tepër zhvillim ekonomik për Kosovën, sjellje të investitorëve të huaj, rritje të mirëqenies sociale dhe krijim të vendeve të reja të punës. Thaçi ka treguar se në kuadër të këtij forumi nuk do të ketë takim të veçantë me homologun serb, por do të ketë diskutim në panel. Ai ka theksuar se sa më shpejt që të arrihet marrëveshja përfundimtare ndërmjet dy vendeve aq më shpejt do të lëvizet drejt perspektivës evropiane. Meqë në këtë forum do të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, presidenti

Thaçi ka treguar se do ta ritheksojë domosdoshmërinë që sa më shpejt të ndodhë liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. "Do t'u bëj ftesë të gjitha shteteve anëtare të BE-së që kanë ende hezitime, që të marrin vendime meritore, sepse nuk kanë nevojë të kenë hezitime të mëtutjeshme për arsye se Kosova ka implementuar të gjitha kriteret dhe standardet për të ndodhur liberalizimi i vizave tash e tre vjet. Pra, duhet të marrë fund ky izolim dhe ky diskriminim për vendin dhe qytetarët tanë", ka thënë ai, duke shtuar se taksa ndaj Serbisë është vendim i drejtë dhe duhet të mbetet në fuqi.

Thaçi ka folur edhe për fushatën e Serbisë ndaj Kosovës dhe për deklarimet e zyrtarëve serbë. Ai ka theksuar se fushata 'Kosova është Serbi' e shkruar në kartëmonedha është më tepër denigruese për vetë Serbinë. "Është e qartë për të gjithë botën se Kosova është shtet i pavarur dhe është atdhe i të gjithë qytetarëve të saj. Orientimi ynë është euroatlantik. Cili është realiteti në Kosovë, flet bota, jo Beogradi. Slogan i ministrit të Jashtëm serb, gjithashtu edhe deklarimi i kryeministres serbe, tregojnë se ata jetojnë në shekullin e kaluar, me një mentalitet të së kaluarës dhe primitiv", ka deklaruar presidenti Thaçi.

LV-ja: Kosova pa sigurime shëndetësore dhe pa mbrojtje sociale për të rrezikuarit

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë theksuar se Komisioni Evropian në raportin e vitit 2019 e cilëson Kosovën vend i cili nuk i garanton plotësisht as shërbimet bazike shëndetësore dhe as mbrojtjen sociale për qytetarët. Sipas këtyre zyrtarëve, ka një dallim të madh mes ligjeve të Kosovës dhe sasisë në të cilën ligjet zbatohen. Sipas zyrtarëve të LV-së, raporti përmend atë që e dimë të gjithë: vdekjet në vendin e punës po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Të drejtat e fëmijëve shkelen shpesh, pasi edhe pse ligji e ndalon punësimin e fëmijëve, 10 për qind e fëmijëve punojnë, madje 6.8 për qind punojnë në kushte të rrezikshme. Skemat sociale janë të fryra, njerëz që nuk kanë nevojë marrin ndihmë sociale, ndërsa shumë familje në nevojë nuk marrin



ndihmën e duhur. E sa i përket Sistemit Informativ Shëndetësor, përmes të cilit do të mblidheshin të dhënat e detajuara për pacientët, realizimi i tij është penguar nga vetë Ministria e Shëndetësisë. Nënkrjetarja e LV-së, Fatmire

Mulhaxha-Kollçaku, ka përmendur pasojat e kësaj gjendjeje në shëndetësi ku, sipas saj, 40 për qind e koston së shërbimeve shëndetësore mbulohet me para nga xhepat e pacientëve. Për më tepër, ajo ka thënë se Kosova nuk është as pjesë e organizatës

Eurotransplant dhe nuk i garanton transplantet për qytetarët e saj. Sa iu përket të drejtave të njeriut, deputetja e Lëvizjes, Saranda Bogujevci, ka thënë se mungon vullneti institucional për zbatimin e legjislacionit në fuqi ku, sipas saj, raporti konstaton se dhuna në familje mbetet shqetësim i madh, me numër të lartë të grave të vrara dhe të keq-trajtuara si dhe të fëmijëve. "Çështja e strehimoreve nuk po zgjidhet sepse qeveria po refuzon të sigurojë financim të qëndrueshëm. Strehimoret mbeten të varura prej vullnetit të subvencionimit. Gjithashtu, nuk ka mekanizma brenda institucioneve që monitorojnë gjendjen e strehimoreve. Dënimet janë shumë të ulëta për veprat penale. Shpesh ato janë të vonuara në kohë dhe shumë prej tyre nuk

janë të formës së prerë. Ende mbetet shqetësim mosmiratimi i projektligjit për të drejtat e fëmijëve dhe mungesa e fondeve për shërbime sociale për ta. E njëjta gjendje është edhe me personat me aftësi të kufizuara. Sa iu takon minoriteteve dhe integritet të komuniteteve të tjera, mungesa e dialogut të drejtpërdrejtë me ta shpërfaq faktin se mungesa e të drejtave dhe të integritet të tyre nuk janë shqetësues për qeverinë tonë", ka thënë Bogujevci. Ajo ka shtuar se prioritet i kësaj qeverie, ashtu si dhe më herët, mbetet asfalti dhe shpenzimet e luksit. "Që të ndryshojë Raporti i Komisionit Evropian për ne, dhe që të përmirësohet marrëdhënia jonë me BE-në, duhet së pari ta ndryshojmë qeverinë dhe t'i largojmë pushtetarët me mentalitet korruptiv", është shprehur deputetja Bogujevci.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është prituri të enjten në Berlin nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel

Haradinaj mori mbështetjen e Merkelit p

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë mbështetje të fuqishme për raportet bilaterale dhe rrugën evropiane të Kosovës nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel. Pas takimit që ka pasur të enjten në Berlin me Merkelin, Haradinaj ka thënë se me kancelaren gjermane ka biseduar edhe për dialogun me Serbinë, duke shprehur skepticizëm se marrëveshja përfundimtare mes dy vendeve mund të arrihet shpejt. Ai ka vlerësuar se pas këtij takimi Kosova është në një pozicion më të fuqishëm pasi ka marrë përkrahjen e Merkelit për mbrojtjen e sovranitetit dhe për vizat. Kurse kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e saj euroatlantike dhe për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të enjten në Berlin është prituri nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, nga e cila ka marrë mbështetjen gjithëpërfshirëse në proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Kreu i ekzekutivit është shprehur i bindur se pas këtij takimi Kosova është në një pozicion më të fuqishëm në të gjitha temat. Ai ka treguar se në takim me gruan më të fuqishme në Evropë ka diskutuar për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, për zhvillimet politike dhe ekonomike, për përparimin si dhe për perspektivën evropiane dhe euroatlantike të Kosovës. "Qytetarët e Kosovës dhe qeveria do të jenë gjithmonë falënderues ndaj Gjermanisë, kancelares gjermane Angela Merkel dhe popullit gjerman për ndihmën dhe përkrahjen që i ka dhënë Kosovës për ndërtimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit si në arsim, shëndetësi, ekonomi, aspektin ushtarak, rend dhe ligj", ka thënë

Haradinaj në takim sipas komunikatës së lëshuar nga Zyra e Kryeministrit.

Duke theksuar vlerat e përbashkëta perëndimore që ndan populli i Kosovës me atë gjerman, Haradinaj ka thënë se vendimi i Gjermanisë për t'i thënë po heqjes së vizave për qytetarët e Kosovës flet për vlerat civilizuese dhe demokratike të një shteti. "Procesi i Berlinit është ndër proceset me rëndësi për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kosova është duke dhënë kontributin e saj në përmirësimin e raporteve të mira fqinjësore dhe në thellimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit", është shprehur Haradinaj.

Ndërkaq në një status në profilin e vet në "Facebook" Haradinaj ka thënë se ishte i nderuar me ftesën e kancelares gjermane Angela Merkel në Berlin për të diskutuar rreth zhvillimeve të fundit në rajonin tonë dhe për nivelin e lartë të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë. "Sa i përket dialogut me Serbinë theksova se ne jemi për një marrëveshje gjithëpërf-

shirëse, ligjërisht obliguese, përfshirë njohjen reciproke, në kufijtë ekzistues. Me këtë rast e falënderova kancelaren Merkel për konsistencën e shtetit gjerman sa i përket mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe për vendimin e Gjermanisë për t'i thënë po heqjes së vizave për qytetarët e Kosovës të cilët, ndonëse i përkasin popullit më proeuropian, gjatë kohë janë mbajtur të izoluar. Nga kancelarja Merkel mora konfirmimin se Gjermania do të vazh-

dojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e saj euroatlantike dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar", ka shkruar Haradinaj.

Kurse kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, sipas komunikatës së qeverisë, duke e cilësuar Kosovën si palë serioze në proceset integruese, ka thënë se Gjermania do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e saj euroatlantike, forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, si dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në të gjitha fushat e interesit reciprok.

Haradinaj thotë se janë dy mundësi për përmbylljen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Pas takimit me kancelaren gjermane, kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar për mediet se janë dy mundësi për përmbylljen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, kjo marrëveshje ose mund të arrihet shpejt me mbështetjen e fuqive perëndimore ose do të ketë një proces të dialogut disa muaj. "Janë dy mundësi: e para është mundësia e një vendimi të madh, dhe ne duhet që ende të shpresojmë në këtë mundësi, sidomos pas përfshirjes së presidentit Donald Trump dhe tash të përfshirjes së

kancelares Angela Merkel dhe presidentit Emmanuel Macron për arritjen e një marrëveshjeje të madhe. Nëse kjo marrëveshje e madhe nuk arrihet, atëherë mundësia tjetër është të ketë një proces disamujorë apo disaveçarë", ka thënë Haradinaj.

Megjithatë, ai nuk beson shumë se do të ketë një marrëveshje të shpejtë. "Mendoj se vështirë është të arrihet marrëveshja e madhe. Ndoshta duhet ta shfrytëzojmë këtë energji për një kornizë marrëveshjeje të parë e cila pastaj do të negociohet në një proces nga një përfaqësues i lartë ndërkombëtar siç ishte Federica Mogherini, por do të jetë një tjetër. Dhe, unë mendoj se Berlino do të ketë prani me një përfaqësues special apo me një të ngarkuar në këtë temë", ka theksuar Haradinaj, duke shtuar se vazhdimi i dialogut dhe arritja e marrëveshjes është në interesin e Kosovës dhe Serbisë.

Ai nuk ka folur shumë për Samitin e Parisit, i cili do të mbahet në fillim të muajit të ardhshëm. Por, sipas tij, qëllimi i këtij samiti duhet të jetë njohja e Kosovës nga Serbi. "Mendoj se marrëdhëniet Kosovë - Gjermani janë më të avancuar nga ky takim. Jam thellë i bindur se janë më të avancuar dhe shpreh falënderim ndaj kancelares për kohën e çmuar që ia ka kushtuar Kosovës", ka thënë ai.

Haradinaj ka deklaruar se është diskutuar edhe çështja e taksës



ër mbrojtjen e sovranitetit dhe për vizat



Sa i përket vendimmarrjes për procesin e liberalizimit të vizave, kryeministri ka treguar se çështja e hyrjes në agjendë të Këshillit të BE-së ende nuk është e përmbyllur. "Do të na duhet shumë punë, ekziston një iniciativë për ta hequr Shqipërinë nga liberalizimi, pra është komplikuar situata, por ne duhet të bëjmë kujdes dhe ta gjejmë mënyrën që të hyjmë në agjendë. Hyrja në agjendë është edhe çështje e afateve kohore,

sepse e drejta na është njohur. Gjermania ka thënë po. Tani duhet të na jepet përkrahja për të hyrë në temë për vendimmarrje. Unë shoh se është vështirë për të hyrë në agjendë për një takim të shpejtë të Këshillit të Evropës. Pra, nuk bëhet fjalë për javë por, ndoshta, duhet të presin dy ose tre muaj deri te vendimi. Mirëpo do të punojmë intensivisht që të hyjmë në agjendë", ka thënë Haradinaj.



100 për qind të cilën Qeveria e Kosovës e ka vënë për importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. "Jemi seriozisht të interesuar për dialog. Taksa nuk hiqet. Nuk është kërkuar heqja e saj. Është biseduar për të në kontekstin e dialogut, por taksa nuk hiqet", është shprehur ai.

Haradinaj takohet me kryetarin e Bundestagut dhe deputetët gjermanë, kërkon mbështetje për liberalizimin e vizave

Gjatë vizitës zyrtare në Berlin, kryeministri Ramush Haradinaj është takuar me anëtarët e Grupit Parlamentar për Evropën Juglindore të Bundestagut, Josip Juratovic, Nezahat Baradari nga SPD dhe Friedrich Ostendorff, Die Grünen. "Me deputetët gjermanë biseduam për zhvillimet e gjithëmbarshme në vend dhe rajon, për bashkëpunimin e ngushtë Kosovë - Gjermani dhe procesin e dialogut me Serbinë. Kam shprehur qëndrimin se Kosova është pro dialogut për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse që rezulton me njohje në kufijtë ekzistues", ka thënë Haradinaj. Ai në këtë takim ka ritheksuar se qytetarët e Kosovës janë të vetmit në rajonin e Ballkanit Perëndimor

që nuk gëzojnë lëvizje të lirë për shkak të regjimit të vizave dhe me të drejtë presin që Gjermania t'i japë këtij procesi epilog pozitiv. "Roli i shtetit gjerman ka qenë dhe mbetet i fuqishëm për konsolidimin e brendshëm e të jashtëm të shtetit tonë dhe aktualisht jemi në pikën kulmore të marrëdhënieve bilaterale me Gjermaninë", është shprehur Haradinaj. Kryeministri Haradinaj në kuadër të vizitës zyrtare në Berlin është takuar edhe me kryetarin e Bundestagut, Wolfgang Schauble, të cilin e ka falënderuar për gjithçka që legjislativi gjerman dhe ai personalisht kanë bërë për Kosovën.



Veseli: Serbia do ta njohë Kosovën dhe do të përgjigjet para drejtësisë për gjenocidin

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

MITROVICË, 6 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të enjten, në shënimin e Ditës së Dëshmorëve të UÇK-së të Komunës së Mitrovicës, se pa Mitrovicën nuk do të bëhej kombi shqiptar dhe nuk do të bëhej Kosova, as liria, as shteti i pavarur dhe sovran i saj. Kreu i Kuvendit ka thënë se njerëzit e këtij qyteti i gjen në çdo faqe të historisë sonë kombëtare. "Kudo ku luftohej e veprohej për çështjen kombëtare, aty ishin njerëzit e Mitrovicës. Ishin luftëtarë e prijës, njerëz të dijes e të kulturës, minorë dhe intelektualë, veprimtarë të lëvizjeve studentore dhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sot ata na

bëjnë krenarë me jetën dhe veprat e tyre në shërbim të atdheut", ka theksuar Veseli. Ai ka shtuar se këtu do të qëndrohet gjithmonë, sepse ky është atdheu ynë që e lanë trashëgim të parët dhe do t'u lihet brezave që do të vijnë më pas. "Kurrë nuk do ta cenojmë askënd dhe kurrë nuk do të lejojmë askënd që ta cenojë lirinë tonë, tokën tonë, shtetin tonë, kufijtë tanë. Dhe sot Mitrovica është vendi më adekuat për ta dhënë këtë zotim. Sot ne jemi zot të vetvetes. Fati i kombit tonë është në duart tona", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se Serbisë i kanë mbetur dy gjëra sa i përket Kosovës: ta njohë shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës dhe të përgjigjet para drejtësisë për gjenocidin e ushtruar mbi popullin tonë gjatë luftës.



Të dyja këto procese, shtoi ai, janë të domosdoshme dhe të pashmangshme. "Liria është punë dhe përkushtim i përditshëm. Liria kërkon, mbi të gjitha, mobilizim institucional dhe qytetar për ta zhvilluar ekonominë e vendit, për ta forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, për të krijuar një shoqëri të drejtë e të barabartë për të gjithë qytetarët tanë, një shoqëri të shanseve për

tar për ta zhvilluar ekonominë e vendit, për ta forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, për të krijuar një shoqëri të drejtë e të barabartë për të gjithë qytetarët tanë, një shoqëri të shanseve për

të gjithë, në mënyrë të veçantë për të rinjtë tanë, kapitalin tonë më të madh njerëzor dhe zhvillimor që kemi", është shprehur kryeparlamentari Veseli, duke shtuar se ky është vizioni në Dekadën e Re të Pavarësisë dhe kjo është rruga që do të ndiqet, pavarësisht prej sfidave dhe pengesave, të çfarëdo natyre qofshin. "Nuk do të ndalemi asnjëherë. Nuk do të dorëzohemi para asnjë sfide, qoftë ajo kombëtare apo ndërkombëtare. Sepse ne jemi bashkëluftëtarët e këtyre heronjve që po përkujtojmë sot. Ne jemi ata që e ndryshuam historinë dhe do ta ndryshojmë edhe të tashmen për ta bërë Kosovën një vend perëndimor ashtu siç e deshën dëshmorët, ashtu siç e duan qytetarët tanë", ka thënë Veseli.

Zeka: Kosova ka përditësuar planin e reagimit për t'u dalë në ndihmë migrantëve

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Në kuadër të planit të reagimit për çështjet e migrimit, të enjten është mbajtur takimi me donatorë, me qëllim të identifikimit të nevojave për mbështetje dhe për t'i shkëmbyer përvojat për menaxhim efikas të këtij procesi.

Takimin e hapi zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh Koordinator Kombëtar për Migrim, Izmi Zeka, i cili ka theksuar se autoritetet e Kosovës kanë përcjellë në vazhdimësi zhvillimet dhe lëvizjet e migrantëve - refugjatëve në regjion. Ai ka thënë se autoritetet e Kosovës që nga viti 2015 dhe në vazhdimësi kanë përpiluar dhe përditësuar planin e reagimit, në bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional dhe

me organizatat ndërkombëtare në Kosovë. "E kemi përditësuar planin e reagimit, i cili parasheh reagimin dhe koordinimin për daljen në ndihmë dhe përbushjen e nevojave për 2 500 migrantë, refugjatë gjatë të gjitha fazave të ardhjes së tyre në Kosovë. Ky plan përfshinë pritjen, regjistrimin, profilizimin, adresimin e nevojave emergjente të tyre, akomodimin, qasjen në procedurat e azilit etj", ka thënë zëvendësministri Zeka. Zeka ka theksuar se në bazë të kapaciteteve tona, për të reaguar në rast fluksi, do t'u ofrohet mbrojtje e gjithëmbarshme migrantëve dhe do të trajtohen duke respektuar të gjitha të drejtat e tyre sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në Kosovë. "Megjithatë, në mënyrë që t'i arrijmë këto kapacitete, ne shpresojmë se do



të hasim në mirëkuptimin tuaj për të na u gjendur pranë, duke na ndihmuar në arritjen e kapaciteteve, respektivisht për të na mbështetur në fushat e caktuara", është shprehur zëvendësministri Zeka.

Në këtë takim folën edhe përfaqësuesit e IOM-it, UNHCR-së dhe organizatave të tjera në

Kosovë që mbështesin procesin e migrimit dhe azilit, të cilët janë partnerë kryesorë të institucioneve për menaxhimin e këtij procesi. Ata premtuan që edhe në të ardhmen do të vazhdojnë t'i përkrahin institucionet e Kosovës.

Në këto diskutime u nxor

përfundimi se lëvizjet e migrantëve - refugjatëve në regjion vazhdojnë, me gjithë luhajat e trendëve. Ne këtë drejtim Kosova mbetet si linjë e komunikimit në mes dy rrugëve kryesore, asaj nga Maqedonia Veriore drejt Serbisë dhe asaj nga Shqipëria drejt Malit të Zi.

Gashi kryeson mbledhjen e RYCO-s: Të rinjtë e Ballkanit Perëndimor të ndihen të barabartë

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në mbledhjen e nëntë të Bordit Drejtues të RYCO-s. Në këtë takim morën pjesë të gjitha vendet anëtare si Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja e Hercegovina.

Gjatë këtij takimi u trajtuan një numër i madh i projekteve dhe programeve rinore, të cilat pritet të implementohen gjatë vitit 2019 në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, projekte këto të cilat kanë për qëllim përbushjen e misionit të RYCO-s sa i përket bashkëpunimit rinor rajonal. "Takimi i sotëm është i një rëndësie të veçantë edhe për të rinjtë e vendeve anëtare në përgjithësi dhe të rinjve kosovarë në veçanti, duke marrë për bazë se shumica e vendimeve për pro-



jektet rinore, por edhe për strukturën e re të RYCO-s po merren në kohën kur Kosova po udhëheq këtë organizatë rajonale rinore, e cila ka dalë nga procesi i Berlinit", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se kjo

mbledhje është jashtëzakonisht e veçantë për procesin e vendimarrjes. "Sidomos pas sfidave që kemi kaluar që nga marsi i këtij viti. Nuk ka qenë periudhë e lehtë dhe sigurisht ka kërkuar angazhim intensiv dhe kompro-

mis për ta tejkaluar ngërçin e krijuar. Ka qenë shumë sfiduese posaçërisht për mua si kryesues i Bordit të RYCO-s për vitin 2019, njëkohësisht përfaqësues i Qeverisë së Kosovës, që të gjejë një zgjidhje e cila do të mundë-

sonte vendimarrje të plotë në RYCO. Andaj edhe dita e sotme është provë që Qeveria e Kosovës është realisht e përkushtuar për ta mbështetur zhvillimin e RYCO-s dhe bashkëpunimin rajonal në përgjithësi", u shpreh ministri Gashi.

Gashi ka theksuar se procesi i vendimarrjes për strukturën organizative të re është determinues për të ardhmen e RYCO-s. "Andaj edhe kam insistuar që përpara çdo vendimi rreth kësaj pike të ketë një takim fizik ku ne do të diskutonim bashkë të gjitha pyetjet, shqetësimet tona në raport me të. Si ministër i Rinisë, por edhe si kryesues i RYCO-s do të bëj përpjekje të vazhdueshme që të rinjtë e Ballkanit Perëndimor të ndihen të barabartë dhe të rëndësishëm në projektet rinore të cilat do të financohen nga RYCO dhe donatorët e saj", ka thënë Gashi.

Thaçi e falënderon udhëheqësen e DIR-it amerikan për ndihmën dhënë FSK-së

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten ka pritur udhëheqësen e ekipit mbështetës në kuadër të Departamentit të Mbrojtjes për Kosovën në ShBA, Abigail Robinson, të cilën e ka falënderuar për kontributin shumëvjeçar në procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës.

Ky ekip, sipas presidentit Thaçi, e kishte përkrahur trans-

formimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës që nga viti 2014, pas Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. "Duke ditur rolin vendimtar të ShBA-së në NATO, jemi të sigurt se procesi i integritit të Kosovës në Aleancën Veriatlantike do të jetë shumë më i shpejtë", u shpreh presidenti Thaçi.

Ndërsa udhëheqësja e ekipit mbështetës në kuadër të Departamentit të Mbrojtjes për Kosovën në ShBA, Abigail Robinson, theksoi se nga viti

1999 ka qenë nder dhe privilegj për të që të merret me Kosovën dhe të kontribuojë në procesin e shtetndërtimit dhe të krijimit të strukturave të sigurisë në Kosovë. "Kam qenë e lumtur që kam punuar në Kosovë dhe për Kosovën gjatë këtyre viteve", ka thënë Robinson.

Thaçi dhe Robinson u shprehën të bindur se bashkëpunimi ndërmjet ekipit të DIR-it amerikan dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Promovohet libri 'Dëshmitar në kohë historike' i akademik Rexhep Qosjes



PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Akademik Rexhep Qosja ka promovuar të enjten vëllimin më të ri të ditarit "Dëshmitar në kohë historike". Në promovimin e këtij libri kanë marrë pjesë personalitete të botës akademike dhe publicistike. Libri "Dëshmitar në kohë historike" nga të pranishmit në këtë promovim është cilësuar një dëshmi e historisë së pashlyeshme jo vetëm e Kosovës, por edhe e Shqipërisë. Autori i librit, akademik Rexhep Qosja, është shprehur i rezervuar për librin, duke thënë se të gjithë ditarët e tij janë shenjë falënderimi për popullin shqiptar. "Duhet të dini një gjë dhe unë ju kam nderuar dhe po ju nderoj. Ditarët e mi janë shprehje e nderimit tim për ju. Dhe jo vetëm e nderimit, por dhe e ndjenjave dhe mendimeve të paqasme që kam unë për ju. Kur them për ju, them atij të cilit i takojmë unë dhe ju bashkër-

ishtë, për popullin tonë", ka thënë Qosja. Për vlerën dhe rëndësinë e librit "Dëshmitar në kohë historike" ka folur edhe ish-kryediplomati i Shqipërisë, profesor Paskal Milo. Duke iu referuar këtij libri, Milo ka thënë se kapacitetet e tilla si akademik Rexhep Qosja nuk i lindin shpesh kombit shqiptar. "Pa dyshim libri, sikurse u tha


këtu, është një dëshmi e historisë. Madje një dëshmi e pashlyeshme e historisë jo vetëm të Kosovës, por fare mirë mund të quajmë edhe një dëshmi për Shqipërinë dhe marrëdhëniet ndërshqiptare. Por, mbi të gjitha, ky vëllim është për mua dhe nuk e teproj të them është një dëshmi e mendjeshmërisë së profesorit. Është një dëshmi që

dëshmon se kapacitete të tilla intelektuale, morale, nuk i lindin kombit shqiptar gjithnjë. Mua më mbetet detyrë të ripërsëris atë që kam thënë shpeshherë, që shqiptarët kudo që janë duhet të kenë për nder që janë bashkohës të Rexhep Qosjes", është shprehur profesor Milo.

Ndërsa profesori tjetër, Agim Vinca, ka thënë se ditarët e akademik Rexhep Qosjes janë vepra të mëdha nga përmbajtja dhe kohëzgjatja. "Ky ditar është njëkohësisht dhe një histori e punës krijuese e punës krijuese të autorit. Në faqet krijuese të ditarit të të gjitha vëllimeve gjejmë shumë të dhëna. Për lindjen, ngjizjen, botimin krijimin, kompozimin e veprave letrare dhe shkencore të shkrimtarit dhe kompozitorit Rexhep Qosja. Nuk mund të shkruhet jetëshkrimi i Rexhep Qosjes, biografia e tij, por as historia e Kosovës pa iu referuar këtij ditari", ka deklaruar Vinca.

Në anën tjetër, drejtori i Institutit Albanologjik, Hysen Matoshi, është shprehur se të gjithë vëllimet e këtij libri dëshmojnë kapacitetin intelektual të akademik Qosjes. "Vëllimi i tetë i kësaj kolone kronologjike e ofron këtë qasje në një mënyrë të veçantë sepse bën fjalë për kthesën më të rëndësishme të Kosovës. Kalimin e saj nga statusi i një province të robëruar në një vend, shtet të lirë. Ky vëllim, bashkë me atë pararendës, në planin e jetëshkrimit shënon dallimin ndërmjet Qosjes si mendimtar në fushën e dijes dhe politikës dhe Qosjes si veprimtar në institucionet zbatuese të politikës", ka theksuar Matoshi.

Epitete intelektuale për autorin e librit "Dëshmitar në kohë historike", Rexhep Qosja, ka pasur edhe themeluesi i shtëpisë botuese "Toena", Fatmir Toqi, shtëpi kjo e cila ka botuar këtë libër.



Pjesa e parë e testit të maturës fillon më 12 qershor

Në regjionin e Prishtinës pjesa e parë e testit të maturës do të mbahet më 12 qershor, në regjionin e Ferizajt dhe të Gjilanit më 13 qershor, në regjionin e Prizrenit dhe të Gjakovës më 14 qershor dhe në regjionin e Pejës dhe të Mitrovicës më 15 qershor

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) ka bërë tërheqjen publike të shortit për renditjen e mbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore nëpër regjione ku, sipas shortit, në regjionin e Prishtinës pjesa e parë e testit të maturës do të mbahet më 12 qershor, në regjionin e Ferizajt dhe të Gjilanit më 13 qershor, në regjionin e Prizrenit dhe të Gjakovës më 14 qershor dhe në regjionin e Pejës dhe të Mitrovicës më 15 qershor.

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i

Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me këtë rast ka thënë se pret administrim të mirë të procesit dhe rezultate të mira në test, ndërsa ka bërë me dije se Ministria e Arsimit ka marrë të gjitha masat që të eliminohen të gjitha dobësitë të cilat janë identifikuar në vitin e kaluar. "Shpresojmë që pas marrjes së informacioneve të renditjes së regjioneve, DKA-të do t'i fillojnë përgatitjet, në mënyrë që testi të zhvillohet sipas procedurave të parapara. Shpresojmë që edhe këtë vit të kemi mbarëvajtje të testit, pasi që viti i kaluar tregoi se kemi pasur një formë më të mirë të mbajtjes dhe vëzhgimit të testit, duke arritur që të kemi rezultate



reale", ka thënë ministri Bytyqi. Ministri Bytyqi po ashtu tha se pritet që të hapet edhe debat publik për ta gjetur formën më të mirë të organizimit të Testit të Maturës, pas debateve publike që janë mbajtur nëpër regjione, për çka

edhe Banka Botërore është shprehur e gatshme që ta përkrahë MASHT-in në këtë drejtim. Renditja e regjioneve sipas tërheqjes së shortit do të jetë e njëjtë edhe në pjesën e dytë të testit të maturës, e cila fillon më 19 qer-

shor në regjionin e Prishtinës, më 20 qershor në regjionin e Ferizajt dhe të Gjilanit, më 21 qershor në regjionin e Prizrenit dhe të Gjakovës dhe më 22 qershor në regjionin e Pejës dhe të Mitrovicës.

Rukiqi jep vërejtje për prolongimin e legjislacionit ekonomik

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka dhënë vërejtje sa i përket vëmendjes institucionale për reforma ekonomike. Ai ka thënë se sektori privat ka harruar kur është miratuar Ligji për reformën ekonomike. Sipas Rukiqit, e gjithë vëmendja është përqendruar tek agjenda politike

**EPOKA E RE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka mbajtur konferencë për medie në lidhje me raportin e Komisionit Evropian (KE) për Kosovën dhe rreth përcaktimit të pagës minimale. Ai ka thënë se sektori privat ka harruar kur është miratuar Ligji për reformën ekonomike. Sipas Rukiqit, e gjithë vëmendja është përqendruar tek agjenda politike. Ai ka theksuar se edhe tek implementimi i të gjeturave të raportit të KE-së vëmendje i është kushtuar anës politike.

Rukiqi ka pohuar se Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit (MSA) ka ngecur së zbatuari, duke përmendur edhe arsyet që kanë ndikuar në këtë ngecje. "Implementimi i MSA-së ka nge-

cur për shumë arsye, qoftë edhe për nga ana e motivit, duke mos pasur edhe një qëndrim të qartë sa i përket integritimit dhe për shkak se vendi dominohet nga politika. Kjo pastaj ndikon në rënien e investimeve të huaja direkte. Sektori privat ka harruar kur është miratuar një ligji për reformën ekonomike. Për shembull, Ligji për TVSh-në nuk dihet as ku gjendet, as kur miratohet", ka thënë ai.

Rukiqi ka theksuar se shqetësues mbetet ende zhvillimi i sektorit privat i cili po ndikohet nga rritja e pagave në sektorin publik, duke theksuar nevojën dhe rekomandimin e OEK-ut që përcaktimi i pagës minimale duhet të bëhet në pajtim me tre aktorët kryesorë: përfaqësuesit e punëdhënësve, përfaqësuesit e punëtorëve dhe qeveria. "Një rezolutë është jashtë çdo logjike, paga

minimale përcaktohet nga punëdhënësi, punëmarrësi dhe qeveria. Ne kemi dhënë një rekomandim që nuk është miratuar në qeveri. Paga minimale nuk i zgjidhë problemet", ka thënë Rukiqi.

Ndërkaq Valon Vataj nga kompania "Kawa" ka thënë se kanë instaluar standarde të reja sa i

përket kushteve të punëtorëve. "Si kompani kemi arritur të instalojmë një standard të ri sa i përket pagës dhe kushteve të punëtorëve. Paga minimale në kompaninë tonë është 500 euro. Ne si kompani do të instalojmë kushte të mira të punës", u shpreh ai.

Kurse Olivera Ceni nga Oda

Ekonomike e Kosovës ka prezantuar të gjeturat e hulumtimit që kanë bërë me bizneset vendore sa iu përket vështirësive gjatë eksportit. Ajo ka thënë se vetëm 10 për qind e kompanive nuk eksportojnë, kurse 82 për qind e tyre kanë deklaruar se produktet e tyre i plotësojnë standardet e kërkuar nga BE-ja.

Tri kompani nga Kosova marrin pjesë në konferencën e Dortmundit



PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Të enjten në Dortmund është hapur konferenca "Purchasing Initiative Western Balkans /BME Einkaufsinitiative Westbalkan", që organizohet nga Asociacioni Federal për Menaxhimin e Zinxhirit të furnizimit, Blerje dhe Logjistikë (BME), Shoqata Ombrellë e Odave të Tregtisë dhe Industrisë Gjermane, në bashkëpunim me Ministrinë Federale për

Ekonomi dhe Energji dhe Odat Ekonomike të Jashtme Gjermane të Ballkanit Perëndimor.

Mbi 50 kompani gjermane do ta kenë mundësinë përmes takimeve B2B (biznes me biznes) me 130 kompani nga Ballkani Perëndimor të gjejnë furnitorë nga Kosova, Maqedonia Veriore, Kroacia, Sllovenia, Serbia, Bosnja e Hercegovina, Shqipëria dhe

Mali i Zi.

Sipas organizatorëve, gjatë kësaj konference do të zhvillohen 700 takime B2B.

Drejtoresha e OEGJK-së, Nora Hasani, ka treguar se çdo vit numri i kompanive të Kosovës që kualifikohen për pjesëmarrje në Konferencën e BME-së për Ballkanin Perëndimor është duke u rritur. "Duke qenë se përzgjedhja e kompanive pjesëmarrëse për takime B2B bëhet

nga blerësit industrialë, dëshmon se kompanitë kosovare si CNC Noll, Mikroni ELD dhe Elsam, që janë sot në Dortmund, kanë prodhime të cilësisë së lartë dhe i plotësojnë standardet që kërkohen nga industria gjermane për t'u kualifikuar si furnitorë potencialë", u shpreh Hasani.

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare në bashkëpunim me Odën e Jashtme Gjermane të

Maqedonisë Veriore dhe me përkrahje të Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman (GIZ) përmes projektit Krijimi i Punësimit përmes Promovimit të Eksportit (CETEP), i përkrah këto tri kompani gjatë konferencës. Pjesë e delegacionit kosovar, përpos OEGJK-së, është edhe organizata partnere KIMERK (Klasteri i Bizneseve të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme).

Punëtorët rrezikohen në punë, kërkohet mbyllja e disa vendpunishteve

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Isuf Azemi, ka thënë se fajtorë kryesorë që punëtorët e sektorit privat janë në gjendje jo të mirë janë qeveria dhe Inspektorati i Punës. Ndërkaq udhëheqësi i Sektorit të Bashkëpunimit në Zyrën e BE-së në Kosovë, Luigi Brusa, ka thënë se legjislacioni i Kosovës i ka të përfshira të gjitha direktivat e legjislacionit të Bashkimit Evropian sa i takon sigurisë në punë, por që ato nuk po zbatohen në praktikë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Tregu i punës në Kosovë karakterizohet me shkelje të mëdha, e lidhur me këtë po kërkohet raportim dhe intervenim më i shpejtë nga aktorët kyçë. Kështu u tha të enjten në tryezën "Rëndësia e sigurisë në punë", organizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe Ministria e Integritimit Evropian që është mbajtur në

qytetin e Pejës.

Udhëheqësi i Sektorit të Bashkëpunimit në Zyrën e BE-së në Kosovë, Luigi Brusa, ka deklaruar se legjislacioni i Kosovës i ka të përfshira të gjitha direktivat e legjislacionit të Bashkimit Evropian sa i takon sigurisë në punë, por që ato nuk po gjejnë zbatim në praktikë. Duke folur për rëndësinë e sigurisë në vendpunishte, Brusa ka thënë se nëpër shumë vende të punës në sektorin e ndërtim-

tarisë, duke nisur nga skelet nëpër të cilat duhet të hipin punëtorët për të punuar, vërehet mungesa e interesimit të punëdhënësve dhe joserioziteti i tyre për sigurinë e punëtorit. Sipas tij, Inspektorati i Punës nuk është duke bërë mjaftueshëm në këtë drejtim teksa ka këshilluar që me urgjencë të mbyllën disa vendpunishte në Kosovë. Ai ka kritikuar edhe sindikatat e punëtorëve që nuk po e ngrehin sa duhet zërin për të drejtat dhe

shkeljet që u bëhen punëtorëve në Kosovë.

Brusa tutje ka thënë se, ndonëse BE-ja ka investuar miliona euro në mjetet e Inspektoratit të Punës dhe, po ashtu, në trajnime, ende nuk kanë parë rezultate konkrete. "Duke ardhur në Pejë pashë dy ndërtesa të cilat skelet i kishin të ndërtuara në mënyrë jo të duhur. Siç thashë, skelet janë një shenjë se sa serioz është kontraktuesi i cili është duke ndërtuar një objekt. Roli i Bashkimit Evropian është këshillëdhënës. Roli ynë është të ndërtojmë kapacitete, por pas kësaj varet nga organet dhe autoritetet e Kosovës dhe nga populli i Kosovës që t'i mbron punëtorët tuaj", u shpreh ai. Udhëheqësja e Iniciativës Kosovare për Stabilitet, Brikenë Hoxha, ka thënë se papunësia

dhe varfëria në Kosovë i detyron punëtorët që të punojnë në kushte të papërshtatshme, pa kontrata pune, me orar të zgjatur dhe në mjedis të pasigurt. Po ashtu, Hoxha ka thënë se nga hulumtimet që kanë bërë si organizatë ka rezultuar se shkaktarët kryesorë të aksidenteve dhe vdekjeve në vendet e punës janë goditje të papritura nga makineria, rrëzimet etj.

Teksa ka folur për shifrat e vdekjeve dhe lëndimeve në vendin e punës, ajo ka deklaruar se ka një mospërputhje të shifrave që i ka Inspektorati i Punës dhe sindikatat. "Për vitin 2017 kemi të evidentuar 21 punëtorë të vdekur, në vitin 2018 i kemi 22 punëtorë të vdekur, ndërsa deri në muajin maj të këtij viti kemi të evidentuar gjashtë punëtorë, ndërsa të dhënat e sindikatës raportojnë për dhjetë punëtorë të vdekur deri më tani", ka thënë Hoxha.

Zëvendëskryeinspektori në Inspektoratin e Punës, Agim Millaku, ka thënë se sfidë kryesore e këtij institucioni mbikëqyrës është mungesa e numrit të inspektorëve dhe nevojja për të kryer trajnime adekuate në terren. Po ashtu, Millaku ka thënë se ngritja e edukimit të punëtorët sa i takon sigurisë dhe shëndetit është sfidë. Ai ka thënë se Inspektorati i Punës është duke bërë vazhdimisht përpjekje që ta rrisë sigurinë në punë përmes inspektimeve të shumta në terren.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Isuf Azemi, ka thënë se fajtorë kryesorë që punëtorët e sektorit privat i kanë sjellë në këtë gjendje janë qeveritarët dhe Inspektorati i Punës. Ai ka thënë se qeveria dhe Inspektorati i Punës, për t'u bërë vetë të pasur, kanë lënë anash sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve. Azemi ka deklaruar se në sektorin privat mbi 50 për qind e punëtorëve janë të punësuar pa kontrata të punës, ndërsa mbi 95 për qind e punëdhënësve nuk e zbatojnë Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive.



Reçica viziton objektin në ndërtim të banimit social në Malishevë

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Deri në fund të këtij viti do të përfundojë ndërtimi i Qendrës së Banimit Social në Komunën e Malishevës, ku do të përfitojnë 44 familje që janë të pastreha. Ndërtimi i kësaj qendre është bërë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komuna e Malishevës. Për t'i parë punimet nga afër, qendrën e ka vizituar ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, i cili ka thënë se nga ky

projekt do të përfitojnë familje që problem kryesor e kanë pasur banimin. "Ky është një projekt i përbashkët i MPMS-së me Komunën e Malishevës, nga i cili projekt do të përfitojnë 44 familje në nevojë, familje të cilat konsiderohen si të pastreha, familje të cilat janë nën kujdesin e asistencës sociale. Ky është një lajm i mirë për përfituesit e këtij projekti, për qytetarët e Malishevës, sepse po bëhet fjalë për akomodimin e 44 familjeve

të cilat problem kryesor e kanë strehimin", ka thënë Reçica. Ai ka deklaruar se nuk do të ndalen së mbështeturi të gjitha familjet që kanë nevojë. Reçica ka thënë se ndërtimi i objektit të banimit social pritet të përfundojë deri në fund të këtij viti. Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se kjo qendër e Banimit Social do të jetë një strehë për të gjithë ato familje që janë të pastreha.



Gjendje alarmante në Fushë-Kosovë pas reshjeve të shiut

Fushë Kosovë, 6 qershor (ER) - Kundërmimi i rëndë nga ujërat e zeza pas reshjeve të shiut ka alarmuar banorët e Fushë-Kosovës. Ata kanë reaguar edhe përmes rrjeteve sociale duke shprehur frikën për ndonjë epidemi të mundshme si pasojë e situatës së krijuar, kurse Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në këtë komunë i ka bërë thirrje Ministrisë së Mjedisit të merret me gjendjen e krijuar.

Reshjet e shiut të mërkurën u kanë shkaktuar telashe të

mëdha banorëve të Fushë-Kosovës, pasi ujërat e zeza kanë vërshuar gjithandej rrugëve të qytetit, në bodrumet e banesave e oborre të shtëpive, duke shkaktuar kundërmim të rëndë gjithandej, ndërkaq kanë shtuar frikën e banorëve të kësaj komune për ndonjë epidemi të mundshme.

Edhe pasi ka pushuar shiu, kundërmimi nga ujërat e zeza vazhdon t'i shqetësojë banorët e kësaj komune. "Reagime të qytetarëve ka pasur në adresë të

PDK-së në këtë komunë, të cilët kanë dërguar fotografi dhe video duke alarmuar për gjendjen e krijuar nga ujërat e zeza. Ata kanë hedhur kritika në drejtim të qeverisjes komunale të Fushë-Kosovës, duke thënë se, ndonëse shumë herë kanë bërë thirrje për gjendjen e kanalizimeve, e të cilat u shkaktojnë telashe të tilla sa herë që ka reshje të shiut, komuna nuk ka ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim", është thënë në komunikatën e PDK-së në Fushë-Kosovë.



Fillon punën shërbimi stomatologjik në QMF-në nr. 3 në Prishtinë

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, i shoqëruar nga drejtori për Shëndetësi, Bujar Gashi, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) nr. 3, me rastin e fillimit të punës së shërbimit stomatologjik si pjesë e kësaj qendre. Ahmeti ka bërë me dije se tani e tutje banorët e Prishtinës të cilët jetojnë në këtë pjesë mund ta shfrytëzojnë

shërbimin stomatologjik, i cili funksionon në kuadër të QMF-së nr. 3. "Sot, bashkë me drejtorin për Shëndetësi, Bujar Gashi, vizitua Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. 3, ku filloi punën shërbimi stomatologjik si pjesë e QMF-së. Prej tash banorët e kësaj pjese të Prishtinës mund t'i marrin shërbimet stomatologjike në këtë qendër të mjekësisë familjare", ka thënë Ahmeti.



Përkujtohen dëshmorët Arsim Tahiri e Xhevdet Krasniqi

SKENDERAJ, 6 QERSHOR (ER) - Janë përkujtuar dëshmorët e kombit, Arsim Tahiri dhe Xhevdet Krasniqi, në 20-vjetorin e rënies së tyre për lirinë e Kosovës, gjatë luftës së lavdishme të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me këtë rast, drejtorët e Komunës së Skenderajt, familjarët, bashkëluftëtarët dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së kanë

bërë homazhe te varret e dëshmorëve, në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë, në shenjë kujtimi dhe respekti për sakrificën e tyre për lirinë e vendit.



Kosnetti merr pjesë në inaugurimin e zyrës së rinovuar të prokurimit në Vushtrri

Vushtrri, 6 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, dhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, kanë bërë inaugurimin e zyrës së rinovuar të prokurimit në këtë komunë. Renovimin e kësaj zyre e ka bërë USAID-i së bashku me Komunën e Vushtrrisë. Me këtë rast, ambasadori Kosnett ka theksuar se Komuna e Vushtrrisë duhet të shërbejë si model edhe për komunitet tjerë sa i përket transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. "Komuna e Vushtrrisë është një shembull për të gjitha komunitet e Kosovës, prandaj ne do ta vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë me

këtë komunë edhe në të ardhmen. Janë pikërisht qytetarët ata që përfitojnë më së shumti kur ka një bashkëpunim të ngushtë mes komunës dhe shoqërisë civile, që është edhe çelësi i suksesit në Vushtrri", ka thënë Kosnett, i cili gjatë qëndrimit në Vushtrri ishte i shoqëruar edhe nga drejtoresha e USAID-it, Lisa Magno.

Ndërsa kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë dhe mbështetjen që populli, ambasada e ShBA-së dhe USAID-i i kanë dhënë komunës së Vushtrrisë me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në punën e saj.



Kush është baba i kombit dhe për cilin komb e keni fjalën!?



Sylejman KRASNIQI

Nocioni "baba i kombit" kohët e fundit shumë po përmendet tek ne. Sidomos nëpër raste përkujtimi në përvjetorë të ndryshëm të figurave me peshë në historinë tonë të bujshme, në artin dhe kulturën tonë të pasur dhe në të arriturat e tjera të shkencës dhe të dijes në përgjithësi, nga shqiptarët përgjatë shekujve. Nocioni "baba" u atribuohet edhe njerëzve me të arritura të veçanta në lëmenj të ndryshëm të shkencave dhe të arteve. Por atyre u thuhet shembull: baba i historisë shqiptare; baba i gjuhësisë shqiptare; baba i mjekësisë, i muzikës, i koreografisë dhe i shumë e shumë fushave të tjera të dijes.

Kemi dëgjuar shpeshherë të thuhet se baba i kombit shqiptar është Gjergj Kastrioti. Disa të tjerë thonë se është Ismail Qemali. Të tretët thonë për Enver Hoxhën. Dy-tre dhjetëvjetëshat e fundit disa e përmendin edhe Rexhep Qosën për baba të kombit. Është një rregull i pashkruar se njeriut nuk është e udhës që t'i jepen tituj dhe epitete për së gjalli sepse jetës nuk i dihet. Secili shprehet sipas shijes dhe orientimit politik e partiak të tij. Por rrallëkush e vret mendjen se

"babai" nuk është pronë partiake e as prodhim i shijes së individit. Në 20-vjetorin e zhdukjes së ideologut dhe vizionarit të pashembullt të çështjes kombëtare shqiptare, Ukshin Hotit, u mbajt një akademi politike dhe shkencore. Atë ditë të gjitha shtëpitë televizive dhanë reportazhe nga ai tubim. Në shumicën e televizioneve, ndër të tjera, u tha se Ukshin Hoti është "baba" i kombit. Mbete i habitur nga këto që i dëgjova. Të nesërmen i hapa gazetën dhe atë çka e kisha dëgjuar dje e lexova në shtypin e ditës. "Andin, baba yt është baba i kombit tonë këtu në Kosovë...", ishte shprehur kryetari i Kuvendit të Kosovës ("Epoka e re" dt. 17 maj 2019 faqe 7). Përnjëherë më shkoi mendja se po të kishim pasur ndonjë rregullorë për t'i shpallur baballarët e kombit, sa baballarë do të na u kishin bërë deri sot? Nga fjalja e thënë më lartë vetvetiu del pyetja se baba i cilit komb duhet të jetë Ukshin Hoti? Baba i pjesës së kombit shqiptar këtu në Kosovë apo baba i "kombit kosovar"? Pse kemi nevojë, ne shqiptarët, të kemi baba në të dy anët e kufirit artificial? Mos edhe kjo e thënë paraqet një sinjal sado të vogël, por zhbirues dhe depërtues, për vazhdimësinë, gati në heshtje për "kombin kosovar"...?! Një gjë është shumë e sigurt: se për të gjallë të Ukshin Hotit, ai kurrë nuk do të pranonte të ishte "baba" i "kombit kosovar". Ndoshta tani është koha të caktohet "babai i kombit" sepse më vonë lehtë mund të plotësohet

edhe ky "vend pune". E nëse unë e kam keqkuptuar fjalën, nëse është menduar për babanë e kombit shqiptar atëherë ky "emërim" bëhet me gjykimin-vlerësimin e të gjitha gjymtyrëve të kombit e jo, kurrësi, nga individit, i cili do nivel qoftë ai. Për këtë duhet ta thotë fjalën shkencë e nivelit akademik dhe shumëdimensional, bile pas një analize së paku pesëdhjetëvjeçare dhe në një ambient tepër të qetë politik e duke i pasur parasysh të gjitha ngjyrat politike, pa asnjë dallim. Bile me këtë përcaktim nuk munden të merren akademitë e tashme shqiptare të copëtuara dhe të ideologjizuara skajshmërisht, por një akademi e vetme shqiptare e mirëfilltë dhe jashtë çdo ndikimi partiak dhe pushtetar.

Me këto pyetje dhe me këto hamendje që po i paraqes unë, pa as më të voglin dyshim, nuk e vë në pikëpyetje vlerën e pamatur intelektuale, politike, atdhetare, vizionin dhe trimërinë e Ukshin Hotit me i dalë zot shqiptarizmit, si rrallëkush tjetër në historinë më të re të Kosovës.

Është bërë zakon kohët e fundit që të ngrihemi në kurriz të vlerave të njerëzve të vdekur duke i përvetësua ato vlera me çdo kusht dhe pa asnjë kriter. Një pasuri që e ke, çfarëdo qoftë ajo, e që nuk ia din vlerën sa e ke në dorë, patjetër se do ta humbësh thotë një fjalë e urtë e jona. Shembulli më i mirë për këtë thënie është vet Ukshin Hoti. Sa

ishite mes nesh nuk ia ditëm vlerën dhe e përbuzëm me çdo kusht duke e lënë anash. Tani mundohemi të përfitojmë në kurriz të ti. Sa ishte mes nesh e lamë në duar të fatit, kur i kishim të gjitha mundësitë që ta shfrytëzonim, si kapital politik kombëtar që ishte. Bile as nuk e kishte shoqin ndër të gjallët. Dyshoj se edhe breza të tërë do të vijnë e do të shkojnë e nuk do ta kemi një kalibër të tillë politikani, mendimtari dhe veprimtari për çështjen kombëtare. Në viti 1981, kur e dënuan dhe në kohën sa e mbajtën në burg, ndoshta edhe nuk kemi pasur mundësi ta ndihmojmë e ta kishim afër, jo për hatër të ti por për nevojën tonë jetike, të kombit dhe të shtetit tonë Si intelektual kulminant që ishte dhe për mendjemprehtësinë dhe nuhatjen e tij të hollë politike që e dallonte nga të gjithë të tjerët bashkëkohanikë të tij, të çfarëdo niveli, por edhe për vizionin që e kishte për të ardhmen e shqiptarisë ai nuk pati mbështetje në asnjërin krah politik. Kur e them këtë mendoj në krahun "institutioanilist" dhe në pjesën e udhëheqjes së UÇK-së. Për të parët, besoj, nuk ka nevojë për sqarim..., kurse për të dytët e kam një bindje se po të kishin qenë pak më të vëmendshëm...do të gjenin një mënyrë për ta liruar nga burgun, bile Ukshin Hoti do të mund të ishte edhe pjesë e delegacionit në Rambuje! E pse klasa politiko-ushtarake e asaj kohe nuk e kushtëzoi shkuarjen në Rambuje me lirim të Ukshin

Hotit dhe me marrjen e ti në delegacion, këtë e dinë vetëm ata!? Mendoj se kjo ka qenë e realizueshme sepse, si rrallë herë në histori, Kosova ka qenë në qendër të vëmendjes dhe e përkrahur nga faktori i jashtëm. Po pas lufte a kemi bërë diçka për Ukshin Hotin? Apo për te po na bije ndërmend vetëm kur na duhen votat. Sa herë është kushtëzua Serbia me gjetjen e trupit, të gjallë ose të pajetë, të Ukshin Hotit në këto bisedime gati dhjetëvjeçare për normalizim të marrëdhënieve? Opinioni nuk ka dëgjua që ndonjëherë është përmend emri i Ukshin Hotit në këto bisedime. Edhe tani kemi pasur mundësi që ta kushtëzojmë Serbinë për shumë gjëra. E pra edhe për gjetjen e trupit të Ukshin Hotit, të gjallë apo të vdekur. Të gjitha këto tregojnë që për fatin e tij nuk kemi shfaqur fare interesim. Na interesojnë vetëm grumbullimi i poenëve politik dhe votat nga fama e tij e fituar me punë, djersë dhe sakrificë, deri në përjetësi, për Kosovën shqiptare dhe për bashkimin shqiptar. E çka po ofrojmë ne pas marrjes së këtyre votave...? Deri tani nuk kemi vërejt ndonjë përparim në cilësinë e asnjë lëmie të jetës...! E mos të flasim për porosinë dhe vizionin filozofik të "babait të kombit" rreth bashkimit kombëtar. Athua ky është babai i kombit tonë a? Sa shumë po u dashka të kujdesemi për babanë e kombit...! Aq sa nuk dimë gjë për fatin e tij! Dhe kjo nuk ka ndodhur në mesjetë, por në ditët tona!

Studentët e Universitetit 'Ukshin Hoti' vizituan Prokurorinë Themelore në Prizren

Qëllim kryesor i kësaj vizite ishte edukimi dhe marrja e njohurive praktike dhe të drejtpërdrejta nga kjo prokurori, ku me këtë rast studentëve mirëseardhje i shprehu zëvendëskryeprokurorja e Prokurorisë Themelore në Prizren, Arijana Shajkovci.

PRIZREN, 6 QERSHOR (ER) - Një grup prej 15 studentësh të Fakultetit Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" kanë vizituar Prokurorinë Themelore në Prizren, të cilët kishin për qëllim njohjen në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë institucion. Qëllim kryesor i kësaj vizite ishte edukimi dhe marrja e njohurive praktike dhe të drejtpërdrejta nga kjo prokurori, ku me këtë rast studentëve mirëseardhje i shprehu zëvendëskryeprokurorja e Prokurorisë Themelore në Prizren, Arijana Shajkovci. Gjatë këtij takimi zëvendëskryeprokurorja Arijana Shajkovci i

ka njoftuar studentët për funksionimin dhe efikasitetin e prokurorisë si dhe ka bërë një pasqyrim të punës së përditshme të prokurorëve. Po ashtu, ajo i ka njoftuar studentët për bashkëpunimin që ka prokuroria me policinë, gjykatën si dhe me institucionet e tjera të drejtësisë. Gjithashtu, studentët u njoftuan edhe me procedurat sa i përket trajtimit të lëndëve, që nga pranimi i kallëzimeve penale, faza e hetimeve, e deri te ngritja e aktakuzave, pushimi i hetimeve apo hedhja e kallëzimeve penale si dhe përfaqësimi i rasteve penale në gjykata.



Nuk është Zvicër por Kosovë. Pamje që të kënaqin syrin



Shkolla fillore “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Shqiponjë, në komunën e Gjakovës, po mahnitë të gjithë me rregullimin dhe mirëmba-

jtjen. Ajo çka ka tërhequr më shumë vëmendjen është oborri i shkollës i cili është i gjithi në gjelbërim dhe me lule.

Kjo pamje fantastike e kësaj shkolle po bën që kjo shkollë të cilësohet më e mira në Kosovë, e madje të krahasohet edhe me shkollat zvicerane.

Por, lëvdata të shumtë kanë marr edhe nxënësit e kësaj shkolle për kujdesin e treguar ndaj mirëmbajtjes së ambientit ku shkollohen. Në oborrin e

shkollës janë vendosur edhe thënie të ndryshme për ambientin, si mesazh për fëmijët që ambienti duhet të ruhet e mbrohet.



Prof. dr. Eqrem Zenelaj nderon Arkivin e Kosovës dhe drejtorin e saj Ramë Manaj



PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Profeshori dhe hulumtuesi i 22 arkivave të Evropës, Eqrem Zenelaj, ka vizituar të enjten Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK), ku është pritur nga drejtori i kësaj agjencie, Ramë Manaj, me bashkëpunëtorë. Profesor Zenelaj në këtë vizitë ka qenë i shoqëruar nga ish-prorektori i Universitetit të

Prishtinës "Hasan Prishtina", aktualisht prodekan i Fakultetit të Filozofisë, profesor i Historisë së Mesjetës, Muhamet Mala, dhe drejtori i gazetës së përditshme "Epoka e re", Sadik Zeqiri. Profesor Zenelaj gjatë kësaj vizite Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës ia dhuroi 133 gravura të figurave të ndryshme kombëtare historike dhe figura të familjeve aris-

tokrate shqiptare. Motivacioni i dhurimit të këtyre portreteve këtij institucioni është që të përkujtohet 2 Korriku i vitit 1990 i shpalljes së Deklaratës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe për nder të vitit të pensionimit të drejtorit të Arkivave të Kosovës, Ramë Manaj, i cili gjatë luftës së fundit dha shumë familjarë të tij për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Në këtë takim u bë me dije se do të organizohet edhe një ekspozitë në Muzeun Kombëtar të Kosovës.

Profesor Zenelaj ka thënë se gjatë muajit korrik Arkivi Shtetëror do të bëhet me një ekspozitë madhështore, pikërisht më 2 korrik. "Në këto portrete janë gravura e Skënderbeut, Gjergj Dhimitër Basta, Papa Klementi XI Albani, Familja Gjika, Dr. ing. Karl Gega, i cili është personi i parë që i ka projektuar hekurudhat në Austri. Po ashtu, është dinastia e Mehmet Aliut në Egjipt, dinastia e Ali Pashë Tepelenës, Aleksandër Moisiut dhe figurave të tjera madhore kombëtare", ka thënë Zenelaj. Në emër të Arkivave të Kosovës, drejtori Ramë Manaj ka falënderuar profesor Zenelaj për punën e tij dhe angazhimin e një hulumtuesi dhe studiuesi të palodhur. Manaj ka shtuar se këto dokumente do ta pasurojnë Arkivin pasi, sipas tij, konsiderohen një thesar me vlerë të madhe për historinë e Kosovës dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Manaj ka inkurajuar edhe të tjerët që ta ndjekin rrugën e profesor Eqrem Zenelajt, që dokumentet me rëndësi kombëtare t'i sjellin për t'u ruajtur në shtëpinë e Arkivit të Kosovës.



Putini mohon ndërhyrjen ruse në zgjedhjet e SHBA-së

MOSKË, 6 QERSHOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, mohoi në mënyrë kategorike se qeveria e tij ka ndërhyrë në zgjedhjet në SHBA duke shtuar se Moska nuk ka qëllim të ndërhyjë as në zgjedhjet e ardhshme. Duke iu përgjigjur një pyetje të agjencisë Asosiated Press, Putini tha se "nuk kemi ndërhyrë, nuk po ndërhyjmë dhe nuk do të ndërhyjmë në zgjedhjet amerikane". Putini dhe zyrtarë të tjerë rusë

kanë mohuar me forcë çdo ndërhyrje në votimet për të ndihmuar fitoren e presidentit të ShBA-së, Donald Trump. Megjithatë, në ShBA, këshilltari i posaçëm, Robert Mueller, përgjatë një hetimi që ka zgjatur rreth 2 vjet ka akuzuar 12 oficerë ushtarakë rusë që përdorën llogari të rrejshme të medieve sociale për të "përhapur retorikën e ndarjes dhe për të minuar sistemin politik të SHBA-së". Prokurori i Përgjithshëm i SHBA-

së, William Barr gjatë prezantimit të një përmbledhje të hetimit pati thënë se nuk është gjetur ndonjë e dhënë se presidenti Trump apo fushata e tij kanë bashkëpunuar me përpjekjet ruse. Këshilltari i Shtëpisë së Bardhë, Jared Kushner, pati deklaruar në fund të muajit prill se hetimet për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet e vitit 2016 në ShBA më shumë kanë ndikuar në demokracinë amerikane sesa vetë veprimet e Rusisë.



Britania dhe Franca nderojnë veteranët e Betejës së Normandisë

Presidenti francez Macron, kryeministrja britanike May dhe presidenti i ShBA-së, Donald Trump, si dhe liderët aktualë të Forcave Aleate Perëndimore, gjatë Luftës së Dytë Botërore janë mbledhur në Normandi për ta shënuar 75-vjetorin e zbkimit të njohur si Dita-D, apo nisja e një operacioni që ka rezultuar me mposhtjen e Gjermanisë naziste

PARIS, 6 QERSHOR - Presidenti francez Emmanuel Macron dhe kryeministrja britanike Theresa May kanë falënderuar veteranët dhe kanë nderuar ata që kanë vdekur gjatë zbkimit të forcave të aleatëve perëndimorë, në veri të Francës më 6 qershor 1944.

Macron, May dhe presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, si dhe liderët aktualë të Forcave Aleate Perëndimore, gjatë Luftës së Dytë Botërore janë mbledhur në Normandi për ta shënuar 75-vjetorin e zbkimit të njohur si Dita-D, apo nisja e një operacioni që ka rezultuar me mposhtjen e Gjermanisë naziste.

Macron dhe May kanë mbajtur fjalime në ceremoninë e mbajtur në Ver-Sur-Mer të Francës, teksa kanë qëndruar afër një memoriali, në të cilin do të shkruhen emrat e mijëra trupave të komandës britanike që kanë vdekur gjatë fushatës.

Veteranët me uniforma në të 90-at e tyre kanë qenë të pranishëm

në këtë ceremoni.

May ka thënë se "nëse një ditë mund të thuhet se ka përcaktuar fatin e gjeneratave të ardhshme në Francë, Britani, Evropë dhe botë, ajo ditë është 6 qershori i vitit 1944".

Për veteranët, ajo ka thënë se, "fjalët e vetme që mund të themi janë 'Ju faleminderit'". Macroni ka falënderuar veteranët dhe "ata që janë vranë, në mënyrë që Franca të mund të jetë e lirë sërish".

Kjo datë do të shënohet më vonë me një ceremoni, ku pjesëmarrës do të jenë Macron dhe Trump, të cilët do të nderojnë ushtarët amerikanë që kanë vdekur.

Gratë e presidentëve, francez dhe amerikan, Brigitte Macron dhe Melania Trump, do të marrin pjesë në një ceremoni në varrezat prej nga shihet Plazhi Omaha, ku forcat amerikane janë përballur me numrin më të madh të viktimave në mesin e forcave aleate, përkatësisht, 2,000 burra.



Macron, po ashtu, pritet të nderojë Komandën e 177-të franceze nga Forcat e Lira Franceze, që kanë marrë pjesë në këtë fushatë ushtarake.

Operacioni i kësaj dite, i udhëhequr nga gjenerali amerikan, Dwight D. Eisenhower, vazhdon të jetë operacioni ushtarak më i madh në histori, duke përfshirë 7,000 anije dhe pajisje tjera përgjatë 70 kilometrave në Gjirin e Normandisë, të cilët janë ndarë në pesë sektorë me emrat e koduar: Utah, Omaha, Gold, Juno, and Sword.

Mijëra persona janë vranë në të dyja palët.

Më 5 qershor, teksa liderët e aleancës kanë nderuar sakrificën e atyre që kanë vdekur në operacionin e vitit 1944, Ministria e Jashtme e Rusisë ka thënë se kjo fushatë nuk ka pasur ndikim "vendimtar" në rezultatin e luftës.

Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, ka thënë se roli i këtyre trupave nuk duhet zmadhuar. "Kontributi i aleatëve perëndimorë në fitoren ndaj Gjermanisë naziste është i kuptueshëm,

mirëpo definitivisht nuk duhet ekzagjeruar, dhe nuk duhet të ulin rëndësinë e arritjeve të Bashkimit Sovjetik, pa të cilin kjo fitore, thjesht, nuk do të ekzistonte", është shprehur ajo.

Presidenti rus Vladimir Putin, që ka marrë pjesë në nderime për 70-vjetorin e kësaj dite, pesë vjet më parë, nuk është ftuar në ngjarjet e këtij viti në Portsmouth. Ish-Bashkimi Sovjetik nuk ka qenë i përfshirë në këtë operacion ushtarak, mirëpo ka pasur rol instrumental në mposhtjen e Gjermanisë Naziste në Frontin Lindor.

Opozita fiton zgjedhjet në Danimarkë

KOPENHAGË, 6 QERSHOR - Kryeministri i Danimarkës Lars Lokke Rasmussen dha dorëheqjen të enjten pas fitores së fuqishme të opozitës Social Demokratike në zgjedhjet e së mërkurës. Premtimi i opozitës për rritjen e mirëqenies bindi votuesit e lodhur me masat shtrënguese ekonomike për të cilat druheshin se do të dëmtonin modelin e famshëm social të atij vendi. Mbrojta e mjedisit po ashtu ishte një çështje madhore për votuesit danez si edhe imigracioni. Të

gjitha partitë kryesore premtoan masa më të rrepta për imigracionin.

Mette Frederiksen drejton të ashtuquajturin "blloku i kuq", të përbërë nga pesë parti të qendrës së majtë. Pas hedhjes së votës të mërkurës, ajo tha se ishte gati të formonte qeverinë. "Populli danez ka pritshmërinë se shumica e re do të sjellë politika të reja, dhe kjo është ajo që shpresoj të shoh", tha ajo.

Kryeministri i dorëhequr, Lars Lokke Rasmussen i Partisë Liberale, tha se qeveria e

udhëhequr nga Social Demokratët do të jetë shumë e varur nga partitë e majta. "Do të thotë se politika ekonomike do të jetë krejt ndryshe. Nuk do të jetë një politikë drejt begatisë dhe rritjes. Kjo do të çojë drejt një situatë ku Danimarka do të jetë më e varfër dhe jo më e pasur", tha ai.

Ndryshimet klimatike zunë një vend të rëndësishëm për votuesit, kryesisht të rinjtë.

Tjetër çështje e rëndësishme ishte imigracioni. Shumë danezë filluan të shohin fluksin



e madh të emigrantëve si një kërcënim për programet e tyre të mirëqenies sociale. Duke mbështetur një qëndrim më të ashpër ndaj imigracionit, Social


Demokratët dobësuan mbështetjen për partitë e djathtë të vijës së ashpër, thotë analistin danez Kasper Moller Hanser.

Një "rrugëtim" i jetës së Ismail Qemalit drejt Kosovës

Një rrugëtim i jetës së Ismail Qemalit, përmes gjurmëve të gjithë veprimtarisë së tij, ka marrë jetë përmes një ekspozite në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Ismail Qemali, ministri i parë reformator dhe liberal i shtetit shqiptar, përmes gjithë objekteve të kësaj ekspozite është shfaqur me një profil të plotë, në përkujtim të 100-vjetorit të vdekjes.

Ekspozita me titull "Rrugëtim-Ismael Qemali ndër vite" u organizua nga Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë dhe Muzeu Kombëtar i Kosovës, në kuadër të Kalendarit të Përbashkët Kulturor. Kjo ekspozitë u mundësua në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Qendrën Mbarëkombëtare të Koleksioneve Shqiptare dhe Bibliotekën Kombëtare. Në ceremoninë e hapjes së ekspozitës, në ambientet e Muzeut Kombëtar të Kosovës, përshëndeti Selim Bazeraj, Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi; Prof. Ass. Dr. Bujar Dugolli dhe Vjollca Aliu, drejtoreshë e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës dhe drejtuese e Muzeut.

"Ekspozita është realizuar për të kujtuar Ismail Qemalin dhe kontributin e tij të paçmuar për mbarë kombin shqiptar. Koha në të cilën lindi dhe jetoi, kultura dhe arsimimi që kishte, kalimi i një pjese të jetës në internim, titujt e ndryshëm që mori në shërbim të Perandorisë Osmane, dashuria për vendlindjen, si edhe kujdesi që t'i shërbente lirisë dhe pavarësisë së atdheut i dhanë Ismail Qemalit aftësinë, që të arrinte realizimin e aspiratës aq të dëshiruar të popullit të tij, ngritjen e flamurit kombëtar dhe Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.", tha Dorian Koçi në një intervistë për "Shqiptarja.com" pas kthimit në Tiranë. Drejtori i MHK-së, Koçi, kujton se ky bashkëpunim erdhi pas suksesit të vitit të kaluar, qw shënoi edhe kulmin e marrëdhënieve mes dy institucioneve qendrore muzeore të Shqipërisë dhe Kosovës, duke organizuar bashkëpunime, aktivitete dhe takime të shumta.



Ismael Qemali ka lindur në Vlorë, në janar të vitit 1844, në qytetin, ku 68 vjet më vonë do të shpallte pavarësinë e Shqipërisë dhe vdiq në Peruxhia më 24 janar 1919. Kuvendi Kombëtar dhe ngritja e flamurit më 28 Nëntor u zhvilluan në shtëpinë ku ka lindur Ismail Qemali. Drejtori i MHK-së, Dorian Koçi e quan të rëndësishëm njohjen e kontributit dhe veprimtarisë së Ismail Qemalit në Kosovë.

Intervista

100-vjetori i vdekjes së Ismail Qemalit është përkujtuar me dhjetëra aktivitete në Tiranë, e sidomos ne Muzeun Historik Kombëtar. Pse menduat qw një përkujtimore e tillw nuk duhet t'i mungonte dhe Kosovës?

-Po dihet, se me veprimtarinë e tij të gjithanshme politike e diplomatike, Ismail Qemali u radhit ndër personalitetet më të përparuara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fillimin e shek. XX. Atdhedashuria dhe kontributi i tij në çështjen shqiptare e ngrënë Ismail Qemalin në krye të figurave tona kombëtare, krahas asaj të Skënderbeut. Ismail Qemali u dallua si frymëzues dhe organizator i kryengritjeve kundërosmane të viteve 1910-1912. Së bashku me Luigj Gurakuqin e patriotë të tjerë hartoi memorandumin e Greçës të qershorit 1911 dhe në fund të atij viti mori nismën për organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912.

I ngarkuar nga rrethet patriotike të vendit, në pragun e Luftërave Ballkanike shkoi në Stamboll

për ta bindur qeverinë osmane t'u jepte shqiptarëve autonominë. Pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike së bashku me Luigj Gurakuqin ndërmoi një aksion të ri politik për të shpallur Pavarësinë e Shqipërisë. Në mbledhjen e Bukureshtit më 5 nëntor 1912 gjeti përkrahjen e kolonisë shqiptare të atjeshme dhe prej andej shkoi në Vjenë, ku u takua me personalitete politike austro-hungareze e me përfaqësues diplomatikë të Fuqive të Mëdha, ku siguroi përkrahjen e tyre për çështjen shqiptare.

Si është konceptuar kjo ekspozitë?

-Ekspozita është konceptuar si një rrugëtim i jetës së Ismail Qemalit. Ajo hapet me fotografinë e tij në moshën 27 vjeçare, në një nga shumë funksionet që ai ushtroi në Perandorinë Osmane, si President i Komisionit European të Danubit. Gjatë gjithë veprimtarisë së tij në administratën shtetërore Ismail Qemali u shqua si njeri me ide liberale dhe reformatore. Për shkak të pikëpamjeve përparimtare dhe liberale Ismail Qemali për t'u shpëtuar ndjekjeve të sulltanit, në maj 1900 u arratis nga Turqia dhe iu kushtua çështjes kombëtare shqiptare. Të gjitha këto pasqyrohen në dokumente që ekspozuam. Arratisja përshkruhet në botimin e datës 4 maj 1900 te gazeta franceze "Le Constitutionnel".

Cilat janë elementë më të veçanta të kësaj ekspozite, ku "udhëtimi"

i Ismail Qemalit shfaqet më i qartë?

-Ekspozita prezanton për publikun objekte vetjake të Ismail Qemalit, si flamurin e tavolinës dhe gotën e ujit. Gjithashtu, ekspozita përmban objekte nga fondi i Muzeut Historik Kombëtar, pena me të cilën u firmos Akti i Pavarësisë së Shqipërisë, aparati telegrafiki përdoruar nga Qeveria e Vlorës, një flamur të vitit 1913, gazeta të vitit 1912, si edhe libra dedikuar Ismail Qemalit.

Udhëtimi i Ismail Qemalit me bashkëpunëtorët e tij në Shqipëri, nga Trieste për në Durrës, përshkruhet në fotografitë dhe shkrimet e gazetave "Le Figaro" dhe "La Presse". Pasi u kthye në Shqipëri, thirri mbledhjen e Kuvendit Kombëtar në Vlorë.

Në këtë Kuvend, që u mbledh më 28 nëntor 1912, lexoi deklaratën e Shpalljes Pavarësisë së Shqipërisë dhe ngriti flamurin kombëtar. Ky akt përmendet në gazetast prestigjioze franceze të kohës "Le Figaro" dhe "Le Gaulois".

Në fillim të janarit të vitit 1913, Qeveria e Përkohshme Shqiptare, e kryesuar nga Ismail Qemali, u dërgoi ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, të mbledhur në Konferencën e Londrës, një memorandum për të mbrojtur kufijtë natyrorë shqiptarë. Ismail Qemali dhe delegatë të qeverisë së Vlorës u nisën për në Europë. Ata vizituan Romën, Parisin dhe Londrën, ku zhvilluan veprimtari të dendur diplomatike në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, për të siguruar mbështetjen e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Këto

momente paraqiten në fotografi dhe në shkrimet e gazetave franceze "Le Matin" dhe "Le Radical".

Ka dokumente për aktin e dorëheqjes së Ismail Qemalit?

-Më 22 janar 1914, Ismail Qemali Vlorë dha dorëheqjen, duke ia kaluar tërësisht pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Me këtë akt u shënuar dhe rënia e Qeverisë së tij, që ishte krijuar nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës më 4 dhjetor 1912. Ky akt është publikuar në shkrimet e gazetave franceze "Le Journal", "Le Matin" dhe "Le Figaro".


Vitet e fundit të jetës Ismail Qemali Vlorë i kaloi në mërgim (Itali, Spanjë, Francë), duke punuar gjithnjë për të mirën e atdheut. Në shtypin dhe arkivat e huaja, si ato shqiptare janë ruajtur të gjitha udhëtimet e Ismail Qemalit, deri në fundin e jetës së tij. Ismail Qemali vdiq në Peruxhia të Italisë më 26 janar 1919. Më 12 shkurt trupi i tij, i vendosur mbi shtratin e topit dhe i mbështjellë me flamurin kombëtar, u shoqërua në Kaninë. Në ceremoninë e varrimit u mbajtën dy fjalime nga Jani Minga dhe nga Qazim Kokoshi. Me rastin e 20-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1932, u vendos në një varr të ri monumental në lulishten pranë Sheshit të Flamurit në Vlorë, me një ceremoni shtetërore të posaçme.

Përmendorja e "Flamurtarit", që ngrihet mbi këtë varr, e realizuar nga Odhise Paskali, simbolizon kurorëzimin e luftës çlirimtare të popullit shqiptar me Shpalljen e Pavarësisë.

E rrallë

Avioni krijon pamjen e jashtëzakonshme në qiell

Një avion pasagjerësh ka krijuar një efekt të jashtëzakonshëm në qiell mbi Gjermaninë, duke lënë pas një pamje me ngjyrat e ylberit. Për shkak të kushteve atmosferike u krijua një shtresë drite që kalonte nga krahët e avionit. Dhe për shkak të këndit të diellit pjerrtësia reflektonte dritën në mënyrë të përkryer duke



krijuar një efekt ylber. Fotografi Nick Beyersdorf kapi fenomenin mahnitës nga toka në Bamberg të Gjermanisë.

BARSOLETA E DITËS



- Doktor, sot i kam pirë barnat në orën 15:15.
- Unë të kam thënë t'i pish në orën 17:45.
- E di, po desha t'ua bëj një surprizë mikrobeve.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



FOTO E DITES



Disa peshkatarë shihen duke peshkuar në një anije në liqenin Lusiai afër qytetit të vogël të Ignalinës në Lituani. /AP/

Ne ora 16:00 dhe 19:00

“AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



E jashtëzakonshme

U ble për 6 dollarë, por guri i shahut vlen miliona dollarë

Kur një tregtar antikësh në Skoci bleu një gur shahu të fildishtë për 6 dollarë në vitin 1964, me shumë mundësi nuk e dinte se kishte marrë një prej gurëve të shahut më të famshëm në botë. I ruajtur në një sirtar për 55 vjet, i quajtur Lewis Warder, mund të ketë një vlerë deri në 1.3 milion dollarë në ankand.



Vlerësimi u bë pasi familja e pronarit të ndjerë e çoi gurin e shahut në shtëpinë e ankandit Sotheby në Londër.



16.05.2019

“THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Sot jeni keq me humorin dhe një ngjarje e papritur do ta përkeqësojë edhe më shumë. Jeni ju të vetmit që duhet ta merrni vendimin si të veproni.



DEMI

Dikush do t'ju bëjë një surprizë të bukur sot duke ju lënë pa fjalë. Hëna në shenjë do të bëjë të përjetoni emocione të forta.



BINJAKËT

Dita sot në përgjithësi paraqitet mjaft e kënaqshme. Nëse shihni në detaje sigurisht që do të zbuloni defekte të vogla që nuk ju pëlqejnë.



GAFORRJA

Do të qartësoni idetë sot falë një miku të mirë dhe do të bëni projekte që do ta favorizojnë mjaft të ardhmen.



LUANI

Mbështetja psikologjike dhe ajo monetare sot do të bëjnë që ju të keni mjaft ide interesante për një biznes fitimprurës.



VIRGJËRESHA

Planetët sot do të eksperimentojnë me sensualitetin tuaj. Edhe për ju që jeni single një takim në mbrëmje do të lerë gjurmë.



PESHORJA

Është e kotë që shtireni si indiferent ndaj një personi që doni patjetër të jetë pjesë e jetës suaj. Do të ndodhë një situatë e caktuar që ju do t'i flisni.



AKREPI

Sot ndiheni më të sigurt në vetvete dhe nga kjo gjë do të kenë përfitim edhe raportet ndërpersonale që kanë qenë mjaft të ndikueshëm nga stresi kohët e fundit.



SHIGJETARI

Do të merreni me gjërat që keni pasion dhe çdo situatë tjetër që mund të duket e turbullt në fillim do të zgjidhet si me magji.



BRICJAPI

Jeni mjaft të ndjeshëm nga çdo lloj tensionimi situatë që ndodh në ambientin familjar. Po i qëndroni pranë një personi të familjes që është në gjendje të vështirë.



UJORI

Shumë projekte interesante kanë zënë mendjen dhe zemrën tuaj. Nuk do të limitoheni t'i mbyllni vetëm punët e përditshme, por po shikoni shumë në avancë.



PESHQIT

Nuk duhet të hezitoni për çka ju duket e drejtë. Nëse e keni vendosur çfarë do të bëni me një çështje të caktuar, mos u ktheni pas.

Rihanna merr me qira një ishull për ta regjistruar albumin e ardhshëm



Rihanna është duke punuar në muzikë të re dhe, sipas "The Mirror", ajo ka rezervuar një ishull privat për vete. Raportohet se këngëtarja ka regjistruar këngë të reja në një studio në ishullin Osea, që gjendet në Essex. Ishulli Osea ka një palestër, kinema dhe pishinë ku

ekipi, miqtë dhe familja e këngëtares mund të qëndrojnë. Qiraja e ishullit kushton 20 mijë funte për një ditë. Kjo është pak si shumë, por Rihanna është këngëtarja më e pasur femër në botë. Javë më parë, Rihanna la të kuptohet se po punon në albumin e saj.



Dua thyen një tjetër rekord, albumi i saj arrin miliarda klikime

Këngëtarja shqiptare Dua Lipa nuk po u ndahet rekordeve botërore. Sukseset e njëpasnjëshme po i korr në sferën ndërkombëtare. Nëpërmjet një postimi në "InstaStory" këngëtarja ka bërë me dije edhe një të arritur tjetër. "Para dy vjetësh Dua Lipa pub-

likoi albumin e saj të ri 'Dua Lipa'. Albumi u kthye në më të dëgjuarin në botë, i krijuar nga një femër, me 10.5 miliardë klikime dhe 3.5 milionë shitje, ku hitet më të mëdha ishin 'New Rules' dhe 'IDGAF!', shkruhet në faqen "Music Facts", të cilin e ka shpërndarë edhe Dua.



Nga kush inspironhet Bebe Rexha?



Këngëtarja e njohur me prejardhje shqiptare, Bebe Rexha, ka treguar se e pëlqen modeluesen Ashley Graham. Këtë e ka bërë me dije me anë të një postimi në rrjetin

social "Instagram". Rexha në këtë postim ka thënë se Graham mbetet një inspirim për të. "Ju jeni një inspirim për mua Ashley Graham, të dua", ka shkruar Bebe Rexha.

Jennifer Lopez me forma të përkryera



Të pasmet bombastike për Jennifer Lopezin ndonjëherë bëhen edhe problematike. Këngëtarja 49-vjeçare, që njihet për format e përkryera trupore, ishte duke shëtitur me të

fejuarin e saj Alex Rodriguez në Miami kur era i fryu fustanin ngjyrë pjeshke nga marka "Chanel" duke zbuluar kështu se poshtë tij kishte veshur ngushtuese.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Kosova kërkon tri pikë ndaj Malit të Zi

Pavarësisht se Përfaqësuesja e Kosovës është mysafire e Malit të Zi në Podgoricë, po synon t'i marrë pikët e plota në këtë ndeshje. "Jemi një grup i bashkuar dhe kemi besim në arritjet tona. Ne e respektojmë kundërshtarin, por do ta japim maksimumin. Jemi këtu për të fituar. Edhe ne kemi shumë mungesa nga ndeshjet e kaluara", ka thënë Vedat Muriqi, sulmues i Kosovës



nuk është kompletuar dokumentacioni i FIFA-s, kurse për Hadërgjonajn është gati për të luajtur", ka thënë Challandes. "Nuk më pëlqen të luaj pa shikues. Besoj se edhe futbollistëve nuk u pëlqen. Do të ishte më mirë të kemi shikues edhe nëse do të na kishin vërshëlyer gjatë gjithë kohës", ka shtuar Challandes. Për ndeshjen ndaj Kosovës foli edhe trajneri serb i Malit të Zi, Ljubisa Tumbaković. Ai ka treguar se i kanë analizuar të gjitha ndeshjet e Kosovës në Ligën e Kombeve

dhe ndeshjen me Bullgarinë, por ka konfirmuar se Mali i Zi do të sulmojë që në fillim. "Ne i kemi analizuar të gjitha ndeshjet e Kosovës në Ligën e Kombeve, ndeshjet miqësore, por edhe ndeshjen ndaj Bullgarisë. Ata luajnë me presion të lartë, kanë lojtarë të mirë, por ne do t'i sulmojmë. Ata nuk kanë pësuar humbje që 12 ndeshje. Ne nuk kemi rezultate të tilla, por kemi luajtur një ndeshje të mirë kundër Bullgarisë, sikurse edhe 60 minuta të mira kundër Anglisë. Synimi i tyre mund të jetë motiv

GRUPI A 20:45 Republika Çeke - Bullgaria 20:45 Mali i Zi - Kosova
GRUPI B 20:45 Lituania - Luksemburgu 20:45 Ukraina - Serbia
GRUPI D 18:00 Gjeorgjia - Gjibraltari 20:45 Danimarka - Irlanda
GRUPI F 20:45 Ishujt Faroe - Spanja 20:45 Norvegjia - Rumania 20:45 Suedia - Malta
GRUPI G 20:45 Austria - Sllovenia 20:45 Maqedonia e Veriut - Polonia 20:45 Latvia - Izraeli

shtesë për neve", ka thënë Tumbaković, i cili më pas refuzoi të tregojë se a do të luajë sulmuesi nga Kosova, Fatos Beqiraj. "Nëse starton Beqiraj, ai do të jetë kapiten. Por, nuk kam vendosur ende nëse ai do të luajë", ka shtuar ai.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e premte) e zhvillon ndeshjen e dytë kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020". "Dardanët" janë mysafirë të Malit të Zi, kurse synimi i tyre është rikthimi nga Podgorica me tri pikë të plota. Sulmuesi në topformë, Vedat Muriqi, ka thënë se respekto për kundërshtarin nuk mungon, por që synimi i Kosovës është fitorja. "Jemi një grup i bashkuar dhe kemi besim në arritjet tona. Ne e respektojmë kundërshtarin, por do ta japim maksimumin dhe jemi këtu për të fituar. Edhe ne kemi shumë mungesa nga ndeshjet e

kaluara. Shumë respekt për Saviqin. Pa marrë parasysh që ai mungon, është bashkëqytetari i vet që do të zëvendësojë, por ne do të japim 100 për qind në këtë ndeshje për të fituar", ka thënë Muriqi, i cili ka shprehur haptas dëshirën që kjo ndeshje të zhvillohej me shikues. Në konferencë për medie foli edhe trajneri i "Dardanëve", Bernard Challandes. Strategu zviceran tregoi se Florent Hadërgjonaj është i gatshëm për këtë ndeshje derisa mesfushori i Viking Stavenger, Yldren Ibrahimaj dhe mbrojtësi i Hereenvenit, Ibrahim Dresheviq, nuk do të luajnë për shkak se ende nuk janë kompletuar dokumentacionet. "Dresheviq dhe Ibrahimaj nuk do të paraqiten pasi që ende

Krasniqi dhe Januzi rikthehen te Prishtina

Skuadra e Prishtinës do ta prezantojë futbollin e Kosovës në garat e Ligës së Evropës. Kryeqytetasit për të pasur paraqitje sa më dinjitoze në këtë garë, të enjten kanë rikthyer dy ish-futbollistët e saj, Endrit Krasniqin dhe Ahmed Januzin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - FC Prishtina pritet të jetë skuadër shumë e fortë në edicionin e ri futbollistik 2019/2020. Klubi nga kryeqyteti, pasi siguroi pjesëmarrjen në Ligën e Evropës, konfirmoi se në krye të skuadrës do të vazhdojë të jetë trajneri Mirel Josa. "Bardhekaltrit" të mërkurën e prezantuan transferimin e shënuesit më të mirë të Drenicës, Kreshnik Uka, derisa të enjten kjo skuadër ka arritur t'i rikthejë edhe dy ish-futbollistët e saj, Endrit Krasniqin dhe Ahmed Januzin. Endrit Krasniqi, i cili e ka lënë skuadrën e Dritës, ka bërë me dije se ka refuzuar shumë oferta për

t'u rikthyer sërish në skuadrën e Prishtinës. "Në Prishtinë rikthem vetëm për një arsye: synimet që ka kjo skuadër. Me Prishtinën pres sezon fantastik. Besoj shumë se do të na përputhen qëllimet, që nga garat kualifikuese në Evropë dhe në kampionat. Tash na mbetet vetëm ta kryejmë detyrën tonë. Bisedimet kanë qenë të gjata, sepse kisha edhe oferta të tjera, por dihet se Prishtina është Prishtinë dhe vendosa të rikthem sërish në gjirin tim. Ekipin e njoh. Pothuajse shumica e futbollistëve janë të njëjtë nga koha kur isha këtu, me pak ndryshime. Jemi ekip i mirë dhe me punë besoj shumë do t'i arrijmë objektivat", ka thënë Krasniqi. Në skuadrën e Prishtinës është

rikthyer vetëm pas një viti edhe ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Ahmed Januzi. Ky i fundit në edicionin e fundit mbrojtësi ngjyrtat e Llapit dhe, përkundër lëndimit, ka arritur të shënojë 13 gola. "Ka qenë dëshirë e dy palëve, e Prishtinës dhe e imja, dhe jam shumë i kënaqur që kthehem sërish. Kam nderin që do të luaj sërish me këtë fanellë pranë shokëve që deri një vit më parë i kam pasur kundërshtarë. Tash ambiciet i kemi të përbashkëta dhe shpresoj shumë se ato do t'ia arrijmë së bashku, sidomos kam shumë besim në kualifikimet e Evropa Ligës. Ekipi është ruajtur ashtu siç e kam lënë, përpos shumë pak ndryshimeve kualitative. Kthimi i Endritit është shumë i qëlluar.



Ndihemi faktikisht si në shtëpinë tonë. Shpresoj shumë se do të kemi sukses, me angazhim maksimal, sepse ekipi është i mirë dhe vetëm sa është përforcuar edhe më shumë. Patjetër që me një trajner si Josa, i cili është me shumë cilësi dhe me vlera të mëdha

njerëzore, do të dijë të na mbajë të grumbulluar", ka thënë Januzi. Tashmë ish-skuadrat e këtyre dy futbollistëve, Drita dhe Llapi, i kanë falënderuar Endrit Krasniqin dhe Ahmed Januzin për kontributin që kanë dhënë dhe i kanë uruar suksese me skuadrën e re.

Sot miqësorja Maqedoni - Kosovë

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Basketbollistët e Kosovës U-20 sot (e premte) në konkurrencën e meshkujve do ta zhvillojnë miqësoren e parë në kuadër të përgatitjeve për Kampionatin Evropian U-20, Divizioni B, që mbahet nga 12 deri më 21 korrik

në Portugali. "Dardanët" janë mysafirë të Maqedonisë U-20, në përballjen që zhvillohet në Mavrovë. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 17:00. Kjo ndeshje do t'i shërbejë përzgjedhësit të Kosovës U-20, Ibrahim Karabegut, për ta parë nga afër formën e lojtarëve.

Basketbollistët e Kosovës U-20 kanë filluar më parë stërvitjet në Prishtinë për të pasur një paraqitje sa më të mirë në Portugali. Kosova është në Grupin C së bashku me Suedinë, Holandën, Gjeorgjinë, Estoninë dhe Armeninë.

ORARI

- 12 korrik Estonia - Kosova
- 13 korrik Kosova - Holanda
- 14 korrik Armenia - Kosova
- 16 korrik Kosova - Gjeorgjia
- 17 korrik Kosova - Suedia



Xhaka: Nuk mund të bënim më shumë ndaj Ronaldos

CYRIH, 6 QERSHOR - Mesfushori shqiptar Granit Xhaka ka folur pas humbjes së Zvicrës nga Portugalia në kuadër të Ligës së Kombeve (3-1). Golat

në këtë ndeshje për portugezët u shënuan nga Cristiano Ronaldo. Paraqitja e yllit të Juventusit u vlerësua lart edhe nga mesfushori

shqiptar Granit Xhaka, i cili ishte kapiten i Zvicrës. "Vërtet krenar për paraqitjen tonë dhe përparimin që po bëjmë. Ndonjëherë nuk

mund të bënim më shumë kur Ronaldo shënon het trik të veçantë", ka shkruar Xhaka në profilin e vet në "Instagram".



12 sportistë e përfaqësojnë Kosovën në 'Minsk 2019'



Prishtinë, 6 qershor - Komiteti Olimpik i Kosovës ka bërë publike listën prej 12 sportistëve të cilët do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e Dytë Evropiane "Minsk 2019" të cilat mbahen prej 21-30 qershorit 2019 në kryeqytetin e Bjellorusisë. Listës i prinë kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi, e cila për herë të parë do të garojë në Lojërat Evropiane, pasi në "Baku 2015" ishte e lënduar. Sporti i Majlindës, xhudoja, prinë me numrin më të madh të sportistëve, gjithsej pesë, të gjithë të kualifikuar me normë. Nora Gjakova (kategoria -57 kilogramë), kampionja e tanishme e Evropës, si dhe sportistja e vetme me medalje në Lojërat Evropiane, do të synojë ta pushtojë podiumin edhe në Minsk. Tre xhudistët e tjerë janë Distria Krasniqi (-48 kg), medaliste e

LISTA E SPORTISTËVE

MAJLINDA KELMENDI, NORA GJAKOVA, DISTRIA KRASNIQI, LORIANA KUKA, AKIL GJAKOVA (XHUDO), ALVIN KARAQI (KARATE), FATIH KARABAXHAKU (PINGPONG), ARDITA ZEJNULLAHU (SHIGJETARI), DONJETA SADIKU, SHPËTIM BAJOKU, PATRIOT BEHRAMI, ARDIT DELIJAJ (BOKS).

argjenditë në kampionatin evropian, Akil Gjakova (-73 kg), kampion i Evropës për U-23 dhe Loriana Kuka, kampionja e Evropës për U-23 (-78 kg). Lojërat Evropiane në sportin e xhudos shërbejnë edhe si Kampionat Evropian. Të njëjtën vlerë e kanë edhe për sportin e boksit, të cilët përfaqësohen me katër sportistë. Kampionja e Evropës për vitin 2016, grupmosha juniore, Donjeta Sadiku, si dhe tre boksierët me të ardhme të ndritur: Shpëtim Bajoku, Patriot Behrami dhe Ardit Delijaj do ta përfaqësojnë sportin e

boksit. Alvin Karaqi, i cili po e ndjek normën olimpikë "Tokio 2020", përfaqëson sportin e karatesë. Shigjetaria përfaqësohet me Ardita Zejnullahun, ndërsa listën e kompletton Fatih Karabaxhaku nga pingpongu. Kosova deri më tani ka një medalje të bronzit në Lojërat Evropiane, të fituar nga Nora Gjakova në Baku 2015. Në "Minsk 2019", Komiteti Olimpik i Kosovës shpreson që sportistët të ngjiten sa më shpesh në podium. Ekipi i Kosovës udhëton drejt Minskut prej 18-20 qershor.

Toronto triumfon në fushën e kampionëve

OAKLAND, 6 QERSHOR - Toronto Raptors fitoi 123-109 ndaj Golden State Warriorsit në finalen e tretë "play-off"-it në NBA, duke udhëhequr 2-1 serinë e ndeshjeve. Edhe pse ndeshja u luajt në fushën e skuadrës kampionë, mungesat e shumta ndikuan në lojën e Warriorsit. Duranti e Thompsoni nuk u aktivizuan, të dëmtuar, ndërsa i vetëm Curry nuk mundi të bëjë asgjë. Curry realizoi 47 pikë, por nuk kishte mbështetjen e pjesës



tjetër të skuadrës, ndaj ishte e pamundur të evitohej kjo humbje. Kanadezët e dominuan gjatë gjithë kohës ndeshjen, duke pasur që në

periodën e parë një epësi prej 12 pikësh, diferencë që shkoi në 17 pikë në çerekun e fundit. Të pestë titullarët e Torontos realizuan mbi 10 pikë, me Leonardon që bëri dallimin, autor i 30 pikëve. Edhe ndeshja e katërt do të luhet në fushën e Golden States, që shpreson në rikuperimin e lojtarëve "big" për t'i rikthyer ekuilibrat në parket. Gjithsesi, ky triumf i Torontos në fushën e kampionëve është një sinjal pozitiv për kanadezët, në kërkim të titullit të parë në histori.

SHKURT

Berisha, afër SPAL-it

Kalimi i Etrit Berishës te skuadra e SPAL-it u fol si një mundësi joshëse fillimisht, por e largët. Gjërat kanë ndryshuar, pasi mediet italiane bëjnë me dije se portieri shqiptar është një hap larg ekipit tjetër të Serisë A. Berisha ka luajtur në 22 ndeshje këtë sezon në të gjitha kompeticionet. Ai humbi vendin në Bergamo, pasi pozitën e titullarit i mori Pierluigi Gollini. Marrëdhëniet e mira mes Atalantës dhe SPAL-it bëjnë që Berisha me shumë mundësi ta vazhdojë karrierën me SPAL-in. Portieri shqiptari mund ta ketë mundësinë që ta gjejë veten.

Gatasaray ofron dy lojtarë për Muriqin

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, është kthyer në objektivin kryesor të Galatasarayt. Kampionët e Turqisë kërkojnë ta fuqizojnë repartin e sulmit duke blerë kartonin e 24-vjeçarit nga skuadra e Rizesporit. Media turke 'Ajansspor' raporton se ndër propozimet e fundit të Galatasarayt ka qenë një marrëveshje ku përfshiheshin dy lojtarë që s'janë më në planet e trajnerit Fatih Terim. Bëhet fjalë për mbrojtësin Ahmet Çalik dhe mesfushorin Emer Bajram. Drejtuesit e Rizesporit nuk e kanë pëlqyer këtë propozim, por bisedimet për sulmuesin shqiptar mbeten të hapura.

Inzaghi vazhdon me Lazion

Trajneri italian Simone Inzaghi ka vazhduar kontratën e tij me Lazion. Inzaghi do të jetë pjesë e Lazios edhe për dy sezone të tjera, pasi ka nënshkruar kontratë deri më 2021. Për të kishte pasur interesim edhe nga skuadrat e tjera italiane, por Inzaghi vendosi të jetë besnik ndaj Lazios që e udhëhoqi sivjet drejt triumfit në Kupën e Italisë. Inzaghi është pjesë e Lazios që nga viti 2016.

Barça kërkon Kimmichin


Barcelona nuk e mbylli edicionin e fundit në mënyrën më të mirë pasi është eliminuar nga Liverpooli në Ligën e Kampionëve dhe më pas humbi në finale të Kupës nga Valencia. Siç raporton spanjollja "Sport", Barcelona ka një ide dhe ajo është e Joshua Kimmich, futbollist i Bayern Munchenit. 24-vjeçari shihet si kapiten i së ardhmes në skuadrën e Bayernit, por ky fakt nuk e pengon skuadrën e Barcelonës që ta kërkojë transferimin e tij.

Erikseni, synim i Interit


Nuk është vetëm Real Madridi, por edhe skuadra e Interit që dëshiron shërbimet e mesfushorit Christian Eriksen. Lajmi është bërë me dije nga "Gazzetta dello Sport", kurse shuma që ofron skuadra italiane për mesfushorin e Tottenham Hotspurit është 70 milionë euro. Vetë futbollisti danez një ditë më parë ka paralajmëruar se dëshira e tij është t'i japë fund aventurës në skuadrën e Tottenhamit në mënyrë që të provojë sfida të reja.

De Gea, pasardhës i Buffonit

Skuadra e PSG-së ka pasur gjithmonë disa nga portierët më të mirë në Evropë, por asnjë nga numrat 1 nuk ka arritur të sigurojë një vend titullari të padiskutueshëm. Kevin Trapp nuk ia doli ta shfrytëzonte mundësinë për të qenë titullar, duke u larguar në formë huazimi te Frankfurti. Alfons Areola nuk ofron siguri, me këtë të fundit që nuk i është besuar ende një fanellë titullari. Buffoni nuk rinovoi. Si pasojë, kampionët e Francës kanë filluar bisedimet me David De Gean, që është pa kontratë me datë 1 korrik. Me shumë gjasë, spanjollli do të jetë numri 1 te PSG-ja për vitet e ardhshme. Areola mund të qëndrojë edhe një vit si numër 2. Ky plan i PSG-së nuk i lë vend portierit gjerman, Trapp, që do të largohet. Skuadra e Newcastleit ka përgatitur 9.5 milionë euro për gardianin e portës, një ofertë që po konsiderohet nga PSG-ja.



Autor: GAZMEND MORINA						SHARRËZ (shq.)	TINGULL QË FORMOHET	QYTEZË NË SHQIPËRI	ILAZ KODRA	TRAJNERI PREKAZI	BASHKËT.	LLOGORE	LIGJ, KANUN (vjet.)	QILIM QË SHTROHET NË NJË ANË TË OXHAKUT	QË KA TË BËJË ME NERVAT	ISMET TOTO	
HEROI NË FOTO																	
NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE											VJERSHË LIRIKE PREJ 14 VARGJESH POROSI E FUNDIT						
REGJISORI HOLLIVUDIAN ... BURTON									ISH FUTBOLLISTI VATA BASHKËT							KOHA KUR NIS TË ZBARDHË DITA	
INSTITUCION I LARTË SHKENCOR													AKTORJA LONGORIA DRU BISHTAJOR I VENDEVE TË NGROHTA				
SHEGË QË U PËRKËT POLEVE, I POLIT									THEMBRA E KËPUCËS ISH "MISS ALBANIA" GENTIANA					OLIVIA GARDEN KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKAN (shqip.)			
→										SMIRA QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP							
SELEN								GJERMAN I VJETËR PËREMËR PRONOR							BASHKËT. MUZIKANTI KRASNIQI		
EPOKA E RE FLETË LETRE PËR DUHAN						KËNGËTARJA JONË MARKU	RI FILLUAR	AKTORJA AMERIKANE ... FARIS	FJJE E HOLLË PAMBUKU	ZANORE IVREA	I PESHOJ VAJ KUZHINE QË PRODDHOHET NË SHQIPËRI		KËNGËTARJA MIRIAM BASHKËT.				
MJEKIM I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME VETËM ME BARNA												CA ISH FUTBOLLISTI PORTUGJEZ ... COSTA				AUTOMOBIL QË SHËRBEN PËR TË MBARTUR MALLRA	
PARAGRAF														QË KA TË BËJË ME ETIKËN QYTET I MADH NË GJERMANI			
FOLTORJA							TANTAL, INTENSITET KASNEC			QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJTË				MA JEP IVAN DIXON			
NJË KONTINENT								EMËRTIM I NJË NOCIONI JON ME NGARKESË POZITIVE			NANTES KËNGËTARJA ELSA	REGJISORJA SHQIPTARE ... ELEZI LETONIA (shk.)				MALMO PORT DETAR	
KAPELË BURRASH ME STREHË										KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM SHPËRDORIM (sh.shq.)			JETA E QETË NË ÇFARË SASIE				
EPOKA E RE KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP TË MADH PEMË E VENDEVE TROPIKALE														AMERICANS INDIAN OPPORTUNITY NJË E PANJ-OHUR NË MATEMATIKË			
KËNGËTARI ASLLANI															DY BASHKË-TINGËLLORE DETYRA E AKTORIT		
ALBERTO TOMBA								I LYER ME LLAK TITAN				REPER I NJOHUR AMERIKAN		VEZË SHUMË TË VOGLA TË PESHQVE HARAÇI			IKACAK, IKANAK (bised.)
PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË									LUAJ NDESHJE		AMPER, ERBIUM				KËNGËTARJA ... MALAJ AKTORJA AMERIKANE ZELLWEGER		
ZANORE								KLUB FUTBOLLI NË ITALI (shq.) SOLISTJA BOKA			ARBEN MALAJ	AKTORJA E NJOHUR ... STRIP (shqip.) TROYES				KRUJA QYTETI FRANCEZ I FILMIT	
NAIM OSMANI								INSTITUTE APPLIED LEARNING	JO TEMATIKE, ATEMORE (bised.)						SHOVA, ECA (bised.) ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. origj.)		
SOLISTJA ... FARA									MË ZË GJUMI DUKE NDENJUR PRODUKT ZJARRI			NËNDARJA E NJË LIGJI BELGJIKJA, AUSTRIA				ARTIOLA TOSKA	
EPOKA E RE TRAJNERI LUSHTAKU BASHKËT.											BASHKËT. TOTENHAM				I SHËMTUAR (krah.) BASHKËT.	NAIM ABAZI BASHKËT.	
KALESË (sh.shq.)															INFIERMERE QË KUJDESOHET PËR GRATË GJATË BARRËS		KALLI MISRI QË VARET NË TRARËT E SHTËPISË PËR T'U THAR

 **REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL - MALISHEVË
MAIN FAMILY MEDICAL CENTRE
"Dr. SHPËTIM ROBAJ"
MALISHEVË
Nr. 226
Data 06.06.2019

Drejtori i QKMF-së "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë, në bazë të Rekomandimit nr.07/72 të dt.31.05.2019 dhe rekomandimit nr.07/75 të dt.03.06.2019 të drejtorit të Shëndetësisë dhe MS në Malishevë si dhe vendimit të këshillit drejtues nr.224 të dt.05.06.2019, nenit 8 të ligjit të punës nr.03/L-212 si dhe nenit 4 të udhëzimit administrative nr.7/2017, për rregullimin e procedurave për konkurs në sektorin public, për plotësimin e vendeve të punës publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për praninë të dy punëtorëve:


Një (1). Doktor Stomatolog në kohë të pacaktuar në QMF-Kijevë me koficienti 7.2 H.26
Një (1). Teknik medicinal I dhëmbëve në QMF- Kijevë në kohë ta pa caktuar. me koficienti. 4.8 H.70

Detyrat e punës Stomatolog:
Ofron shërbime shëndetësore nga lëmia e stomatologjisë në QKMF, QMF.
Siguron kujdes primar oral shëndetësor për të gjithë qytetaret pa dallim: kombi, etnie, feje, race, gjinie.
Nxjerrë dhëmbë, sheron dhëmbë, shkruan terrapinë, në bazë të diagnostifikimit, udhëzon pacientët në qendra tjera spitalore Stomatologjike, bashkëpunon me mjekë tjerë stomatolog, për punën e vetë i përgjigjet shefit të Stomatologjisë dhe drejtorit të QKMF-së.

Detyrat e punës Teknikut medicinal të dhëmbëve:
Mban librin protokoli të pacienteve, i shenon pacientet dhe mban rendin, i ndihmon stomatologut, përgadit materialin për mbushje të dhëmbëve, i kryen pagesat e participimit dhe në fund të muajit barazohet në kontabilitet.

Kushtet e konkursit:
-Për Stomatolog: Diploma e Fakultetit të mjekësisë drejtimi i Stomatologjisë dhe Licencën e punës,
-Për Teknik medicinal të dhëmbëve: Diplome shkollës së mesme medicinal teknik i dhëmbëve. Licencën.
-Kushtet e përgjithshme: Certifikatën e lindjes, Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i denuar.
-Certifikatën e mjekut për punë, Leternjoftimin e fotokopjuar.

-Kohëzgjatja kontratës: në kohë të pa caktuar (pas periudhës provuese tremujore).
-Orët javore të punës 40.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjete te informimit, aplikacionet e arritura pas afatit nuk pranohen, aplikacionet me dokumenta të pa kompletuara nuk shqyrtohen. dokumentacioni dorëzohet në zyrën e personelit të QKMF-së.


Drejtori
Dr. Nuhi Morina - sp. Pëdiater

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "General Accounting Office" L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 70928787 dhe nr.fiskal: 600928074 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "General Accounting Office" L.L.C. Fushë Kosova, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 70928787 broj fiskala: 600928074 Artrin Bajrami, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "General Accounting Office" L.L.C, in Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 70928787 i number fiskal: 600928074 Artrin Bajrami, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

INSPEKTORATI I PUNËS

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Inspektorati i Punës bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil dhe në Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 22 paragrafi 3, vazhdon afatin e konkursit të shpallur më datë 21.05.2019 edhe për shtatë (7) ditë tjera kalendarike nga data 07.06.2019 deri me datën 13.06.2019, për pozitat si në vijim:

1. Inspektor i Punës (20 pozita)

Kriteret e konkursit mbeten të njëjta si në konkursin e mëparshëm. Kandidatët që kanë aplikuar në afatin e rregullt të konkursit për pozitat e lartpërmendura nuk kanë nevojë për riaplikim.

OBAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Inspektorat Rada, na osnovu člana 11 Zakona o Državnoj Službi i Pravilnika br. 02/2010 o Procedurama Zapošljavanja u Državnoj Službi člana 22 stav 3, nastavlja sa produženjem roka konkursa objavljenom dana 21.05.2019 godine jos za sedam (7) ostalih kalendarskih dana počevši od 07.06.2019. do 13.06.2019, za sledeće pozicije:

1. Inspektor Rada (20 pozicije)

Kriterijumi za konkurs ostaju isti kao i na prethodnom konkursu. Kandidati koji su konkurisali na redovnom konkursu za pomenuta radna mesta nemaju potrebe za ponovno konkurisanje.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, "VPD Drill" Sh.p.k Dragobil, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Dragobil, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.07.2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "VPD" në fshatin Dragobil-Malishevë, i cili gjendet në rrugën kryesore Malishevë - Rahovec do të organizohet debat publik nga kompania "VPD Drill" Sh.p.k Dragobil, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Dragobil, Malishevë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Naim Frashëri"

Komuna: Gillogoc

Data: 07.06.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/010-ESIP/SDG/010-G/1.2	Blerja e mjeteve të teknologjisë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës SHFMU "Naim Frashëri" Global, Gillogoc. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Laptop 3 Copë
- Miksetë 1 Copë
- Altoparlante 2 Copë
- Shtyllambajtëse 2 Copë
- Mikrofon 2 Copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Naim Frashëri" Global, Gillogoc, më së largu deri më 17.06.2019

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues:

Shkurte Dvorani

Telefoni: 044-362-514

E-maili: shkurte.dvorani@hotmail.com

N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A.
FERIZAJ
Nr. 83 Data 6.06.2019



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA



Ndërmarrja Publike Lokale
"Stacioni i Autobusëve "Sh.A.
FERIZAJ

Kryeshefi Ekzekutiv i Stacioni Autobusëve Sh.a.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Organogramin, lidhur me plotësimin e vendit të punës, shpallë:

KONKURS

ME KOHË TË CAKTUAR 1 VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës.(1) Dispiçer

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV

1. Shkolla e mesme
2. Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit
3. Shkathësi të shkëlqyeshëm komunikues
4. Shkathësi të shkëlqyeshëm për kompjuter (Certifikatën nga ndonjë institucion kredibil).
5. Përvoja e punës është e dëshirueshme
6. Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim. Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikat e kompanisë. Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrë e kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund të dorëzojnë aplikacionet.

Dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të konsiderohet të vlefshëm. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit të dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej orës 8- 16 :00.

Ferizaj , më 06.06.2019

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Kryeshefi Ekzekutiv
Gazmend Bityçi

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Gashi Ing" Sh.p.k Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për implantin e prodhimit të betonit dhe prodhimet nga betoni në Shirokë komuna e Suharekës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.07. 2019 në ora 11:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë "Gashi Ing" Sh.p.k në adresën: Rr. Dëshmorët e Atlantikut p.n. Shirokë komuna e Suharekës do të organizohet debat publik nga kompania "Gashi Ing" Sh.p.k Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për implantin e prodhimit të betonit dhe prodhimet nga betoni në Shirokë komuna e Suharekës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Sot u bënë pesë vite pa më të dashurin tonë

JUSUF (MURAT) BERISHA

(15.07.1958-07.06.2014)

Muajt dhe vitet kalojnë por nuk e shuajnë dhimbjen, kujtimin, dashurinë, dhe respektin për Ty.

Mungesa jote është zbrazëti që nuk plotësohet kurrë, ndërsa kujtimi për ty do të jetë pjesë e jetës tonë përgjithmonë.

Të përkujtojnë me mall dhe dashuri pa fund, familja Berisha!

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Kastriot Thaqi shpallë të pavlefshme Diplomën e Kolegjit "Biznesi" Prishtinë.
- ▶ Gentijana Morina shpall te pavlefshme deftesat diplomën certifikatën shmgi "Remzi Ademaj" Prizren
- ▶ Sabina Shala shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shf "Lidhja e Prizrenit" Prizren
- ▶ Kujtim Kokollari shpall te pavlefshme diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren
- ▶ NTSh "Olym Cos" shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit 80663498 Prizren
- ▶ Rymejsa Topojani shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shf "Matilo Goreci" Prizren
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpeite



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA Since 1899